



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DURRËS

**INFORMACIONI**  
**PER MEDIAT**

Në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. 2466, të filluar në datën 29.11.2019, në ngarkim të:

Ka rezultuar se:

Me datë 29.11.2019, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ka regjistruar kryesisht procedimin penal Nr.2466, viti 2019, pasi me datë 26.11.2019, në orën 03:54, në Durrës ka rënë një tërmet me magnitudë 6.4 të shkallës richter, i cili ka zgjatur rreth 30 sekonda.

Si pasojë e këtij tërmeti u dëmtuan një numër i konsiderueshem banesash dhe objektesh të tjera, si dhe kanë gjetur vdekjen 23 persona në territorin në të cilin ushtrone veprimtarine Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë Durrës.

Hetimet kanë filluar pasi dyshohej se dëmtimet e këtyre godinave dhe pasojat në vdekjen e njerëzve kanë ardhur edhe si shkak i ndërtimeve të kryera pa respektuar rregullat, normat dhe standardet në fushën e ndërtimeve, si dhe për shkak të ndërtimeve të kryera pa lejen e organeve kompetente. Po kështu ka dyshime se këto pasoja kanë ardhur edhe si shkak i kryerjes apo moskryerjes së detyrës nga inxhinierët zbatues, mbikëqyrës dhe kolaudatorë të këtyre ndërtimeve, si dhe nga moskryerja e detyrës nga nëpunësit shtetërorë dhe publik të ngarkuar me kontrollin e mbikëqyrjen e këtyre ndërtimeve.

Objektet në të cilat u shkaktuan pasoja në jetën e njerëzve ishin objektet si më poshtë vijon:

- Objekti banesë private katër katëshe e familjes “LALA”, lagjia nr.17, rruga “Mihal Rama”, Durrës, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetasit Marjeta Lala, Amelja Lala, Emilio Lala, Enis Lala, Dionisa Lala, Sehadete Lala, Ilir Lala dhe Grisilda Lala.
- Objekti i banimit 6-katësh, pallati nr.1650, (Pallati i Konomëve), afër ish-“Kryqit të Kuq”, lagjia nr.18, Durrës, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetasit Eduart Reçi, Dolora Reçi, Kristi Reçi, Klaus Reçi, Rozeta Meçaj, Diena Karanxhaj dhe Esiela Karanxhaj.
- Objekti “Hotel Tropikal”, lagjia nr.13, Durrës, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën dy shtetas kosovarë (dy vëllezërit Shemsedin Abazi dhe Isah Abazi).
- Objekti “Hotel Mira Mare”, lagjia nr.13, Durrës, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetasit Sotiraq Misha dhe Evjola Broshka.
- Objekti i banimit 6-katësh, pallati nr.1032, i ndodhur në rrugën “Shoqëria Bashkimi”, lagjia nr.6, Durrës, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetaset Nafije Rexhepi dhe Zhuljeta Gjana.
- Objekti “Hotel Vila Palma”, në zonën e quajtur Shkëmbi i Kavajës, plazh, Durrës, nga shembja e të cilit ka humbur jetën shtetasi Sadik Qato.
- Objekti pesë katësh “Hoteli Nr.4”, “Shtëpia e Pushimit të Ministrisë së Brendshme”, lagjia nr.13, plepa, Durrës, nga shembja e të cilit ka humbur jetën shtetasi Bajram

Hajdarmetaj, me detyrë pedagog në Akademinë e Rendit, i cili ishte akomoduar atë natë në këtë objekt.

Nga hetimet e zhvilluara për çdo objekt ndërtimor të shembur ka rezultuar si më poshtë:

**1. Objekti banesë private katër katëshe e familjes “LALA”,** lagjia nr.17, rruga “Mihal Rama”, Durrës, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetasit Marjeta Lala, Amelja Lala, Emilio Lala, Enis Lala, Dionisa Lala, Sehadete Lala, Ilir Lala dhe Grisilda Lala. Ky objekt ishte ndërtuar pa lejen e organeve kompetente dhe për të cilin pronarët e tij me përfaqësuese të ndjerën Sehadete Lala kishte aplikuar duke plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizim në vitin 2005 dhe më pas edhe me një formular shtesë në vitin 2006. Nga ana e ALUIZNI-T Durrës, objekti është legalizuar me datë 30.10.2015.

**1.1.** Nga ana e policisë gjyqësore është administruar pranë ASHK Durrës praktika e të gjithë dokumentacionit që ka shërbyer për legalizimin e ndërtimit pa leje pranë ALUIZNI-T Durrës. Nga verifikimi i dosjes së Aluizni-t janë marrë në cilësinë e provës materiale dokumentat si më poshtë vijon:

- Dosja e objektit pa leje me reference me Nr. 0010575, ZK.8511, Nr. Pas. 18313, vol. 48, fq. 64, me pronar Sahadete Lala.
- Leje Legalizimi nr. 151151 datë 30.10.2015 godinë banimi katër kate mbi tokë me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 427.78 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 118.8 m<sup>2</sup>, sipërfaqja totale e banimit 676.8 m<sup>2</sup>.
- Kontratë shitje pasurie midis ALUIZNI-T dhe Sehadete Lala. Kalimi i pronësisë për pasurinë me nr. 18/167, me sipërfaqe 427.78 m<sup>2</sup>, në Zk. 85.11, sipas VKM nr.1481 datë 12.11.2008.
- Gentplani i pregatitur nga Sektori i Hartografisë dhe Përpunimit të Informacionit Gjeografik në ALUIZNI Durrës.
- Plan Rilevimi.
- Akt Kualifikimi Nr.8907 datë 06.08.2015,
- Formulari i Vetëdeklarimit Nr. 776 datë 24.02.2005, përpiluar nga Sehadete Lala.
- Vetëdeklarim për legalizimin e objektit nr. 815 datë 29.08.2006, ku është pasqyruar viti i ndërtimit të objektit 06/2002. Gent Plan i datës 09.08.2008 për të katër katet e ndërtesës.
- Procesverbal Verifikimi në terren i datës 08.10.2014. Ortofoto digjitale datë 14.04.2007.
- Formularët e pagesave sipas deklaratave dhe mënyrës së pagesës së bërë nga aplikuesi. Deklaratë Personale e datës 08.201.2014 e firmosur nga deklaruesi Sehadete Lala e cila sipas formularit deklaroi se mbart mbi vete koston e dëmtimeve që vijnë si pasojë e punimeve të kryera në objekt për shkaqet natyrore, kur nuk janë respektuar kushtet teknike, përdorimit të objektit ndërhyrjet në rikonstrukcionin mbajtës të objektit.

Më tej, në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore si:

- Këqyrja e vendit të ngjarjes së bashku me tabelat fotografike përkatëse.
- Marrja e mostrave të hekurit dhe betonit në rrënojat e këtij objekti.
- Analizat laboratorike të cilësisë së hekurit dhe betonit.
- Informacion nga Instituti i Gjeoshkencave Energjisë, Ujit dhe Mjedisit lidhur me lëkundjet e tërmetit të datës 26.11.2019.
- Studimi Sizmiologjik.
- Studimi Gjeologjik i sheshit të ndërtimit.
- Dokumentacioni tekniko-ligjor i objektit.

Në kuadër të hetimit të kësaj çështje penale, nga ana jonë janë thirrur dhe janë pyetur shtetasit Blerim Lala, Albert Lala, Ilir Ibraj, Shefqet Bego, Serjan Mazrreku, Sefer Cenga, Ardian Nuho, Vasil Gjoni, Nevjana Isufi, Ilirjan Keci, Farie Gaxha, Naim Imeraj, Luiza Lala, Shkelqim Lala, Blerim Gaxha, Gerti Aleks, Elvis Pengili, Rovin Zeqo, Nadir Kapaj, Gerlad Kaci, Lefter Terova, Kastriot Kapllani, etj.

Nga deklaratimet e personave që tregojnë rrethanat e hetimit dhe kryesisht të anëtarëve të familjes Lala, por edhe të shtetasve Ardian Nuho, Naim Imeri, Blerim Gaxha, Farie Gaxha, etj, rezulton se objekti nuk është ndërtuar nga ndonjë kompani ndërtimi, por është ndërtuar nga një grup punonjësish ustallarë të palicensuar në punimet në ndërtim të drejtuar nga ana e shtetasit Ramiz Shehu, i cili është paraqitur si teknik ndërtimi. Rreth viteve 2002 – 2003, shtetasi Ramiz Shehu në cilësinë e një sipërmarrësi ka rënë dakord me shtetasit Blerim e Albert Lala për të kryer projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit për objektin me katër kate sipas kushteve teknike të ndërtimit. Nga hetimi nuk konstatohet hartimi i ndonjë kontrate apo marrëveshje me shkrim, por sipas deklaratimeve marrëveshja është lidhur me fjalë dhe ata i kanë paguar punën e bërë shtetasit Ramiz Shehu, i cili për disa vite ka kryer ndërtimin e objektit. Për ndërtimin e banesës Ramizi ka bërë gjithëçka vetë, që nga blerja e materialeve e deri në fund, sa ata kanë hyrë familjarisht në këtë banesë. Pagesa mesa i kujtohet ka qenë me më shumë katrorë. Në lidhje me projektin e banesës është marrë Ramiz Shehu, sipas porosisë që ata i kanë bërë që të ndërtonte një banesë me katër kate, me qëllimin që secili nga tre vëllezërit Lala të kishte nga një kat për banesë dhe kati i parë të shërbente si garazh pasi mendohej se mund të kishte lagështi. Në lidhje me ndërtesën ata i kanë dhënë lekët për aq sa Ramizi ju ka kërkuar dhe i kanë kërkuar që ti garantonte për cilësinë (hekur, çimento dhe beton). Të gjithë ndërtimin e banesës e ka kryer Ramiz Shehu, ndërsa disa persona të tjerë në një kohë të mëvonëshme kanë bërë suvatimin e objektit.

Nga ana jonë me qëllim sqarimin e fakteve nëse, Projektimi, Zbatimi, Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i ndërtesës godinës ish-objekt banesë katër katëshe e familjes “LALA”, lagjia nr.17, rruga “Mihal Rama”, Durrës, ka qenë në përputhje me kushtet teknike kombëtare dhe kuadrin rregullator ligjor për ndërtimin në RSH si dhe për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë shembjen e ndërtesës është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik në fushën e ndërtimit.

Nga Akt Ekspertimi Teknik në lidhje me ish-objektin banesë katër katëshe e familjes “LALA”, lagjia nr.17, rruga “Mihal Rama”, Durrës, ka rezultuar ndër të tjera se: *Në lidhje me objektin “Ndërtesë 4-kat në pronësi të familjes Lala, lagjia nr.17, Durrës” i shembur nga tërmeti i datës 26.11.2019, nuk gjendet asnjë dokument tekniko-ligjor në zbatim të Ligjit Nr. 8405 dt. 17.09.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar dhe Ligjit Nr.8402, dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ndryshuar. Këto mangësi në dokumentacion, të cilat me sa kuptohet nuk kanë ekzistuar asnjëherë, nxjerrin si konkluzionin që kjo ndërtesë nuk është Projektuar, Zbatuar dhe Kolauduar në zbatim të kuadrin ligjor në fuqi në vendin tonë në kohën e kryerjes së ndërtimit. Sa i përket zbatimit të KTP dhe KTZ të pacaktuara në VKM Nr. 68, dt. 15.2.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, grupi i ekspertëve shpreh qartësisht që ato nuk janë marrë në konsideratë.*

*Si konkluzion: Shembja e “Ndërtesës 4kat në pronësi të familjes Lala, lagjia nr.17, Durrës”, ka ndodhur nga disa faktorë të cilët janë parqitur në aktin e ekspertimit por kryesisht nga:*

- *Dëmtimet paraprake të tërmetit i 21 Shtator 2019 me Magnitudë 5.6;*
- *Cilësia e dobët e materialeve (betonit) të përdorura për ndërtimin e objektit;*
- *Mos zbatimi i KTP dhe KTZ në fazën e projektimit dhe zbatimit të ndërtesës.*

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së ndërtimit të objektit banesë katër katëshe e familjes “LALA”, lagjia nr.17, rruga “Mihal Rama”, Durrës, shtetasi Ramiz Shehu në

cilësinë e projektuesit dhe zbatuesit të punimeve të ndërtimit pa leje me veprimet dhe mosveprimet e tij ka konsumuar elementët e veprës penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, në dëm të tetë viktimave dhe konkretisht të të ndjerëve Marjeta Lala, Amelja Lala, Emiljo Lala, Enis Lala, Dionisa Lala, Sahadete Lala, Ilir Lala dhe Grisilda Lala. Shtetasi Ramiz Shehu ka marrë përsipër dhe ka kryer ndërtimin e objektit katër katësh, pa respektuar rregullat dhe normat ligjore në fushën e ndërtimit për sa i përket studimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit ndërtimor, gjë e cila ka sjellë si pasojë shembjen e objektit nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe vdekjen e tetë shtetasve të sipërpërmendur që gjendeshin në këtë objekt, nga i cili fatmirësisht shpëtoi vetëm shtetasi Ram Lala pas ndërhyrjes së forcave të kërkim shpëtimit.

Nga ana e shtetasit Ramiz Shehu pavarësisht se po ndërtonte një objekt ndërtimor katër katësh me funksion të banimit të qytetarëve (kërkuesve të investimit), në kundërshtim me ligjin, pasi ai nuk ka patur licensë në asnjë nga fushat e ndërtimit sikurse janë ato të studimit, projektimit, mbikëqyrjes, zbatimit apo kolaudimit të objekteve të ndërtimit. Por, edhe në cilësinë e sipërmarrësit ai nuk ka pajtuar asnjë specialist të fushës së projektimit dhe ndërtimit me qëllim kryerjen e studimit gjeologjik, sizmik dhe më pas hartimin e projektit konstruktiv të objektit. Po kështu, edhe gjatë zbatimit të punimeve nuk është mbajtur asnjëlloj dokumentacioni që lidhet me cilësinë e materialeve të ndërtimit, cilësinë e punimeve dhe mbi volumet e punimeve të kryera në këtë objekt, (libër masash mbi punimet e kryera dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit të përdorur, situacionet e punimeve, akt kolaudimi apo ekspertimi teknik lidhur me qëndrueshmërinë e objektit).

Shtetasi Ramiz Shehu me dashje direkte e ka kryer ndërtimin e objektit në mënyrë të kundraligjshme dhe pa lejen e organeve kompetente, duke besuar tek aftësitë e tij apo personave që kanë marrë pjesë në ndërtimin e këtij objekti, se objekti mund të jetë i qëndrueshëm nga pikëpamja teknike, por pasojat e ardhura nga shembja e ndërtesës së ndërtuar nga ai kanë ardhur nga pakujdesia, pasi ai nuk i ka parashikuar pasojat që mund të vinin, megjithëse sipas rrethanave në të cilat është kryer ndërtimi ai duhet ti parashikonte. Shtetasi Ramiz Shehu, nuk i është përmbajtur legjislacionit në fushën e ndërtimit lidhur me KTP e KTZ, pasi nuk ka respektuar asnjë nga rregullat dhe normat në fushën e ndërtimit në fuqi në kohën e kryerjes së këtij ndërtimi.

Nisur nga sa më sipër dhe mbështetur në faktet dhe provat e administruara në funksion të hetimeve të procedimit penal nr.2466 viti 2019 rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij shtetasi Ramiz Shehu ka konsumuar elementët e veprës penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal tetë herë, në dëm të viktimave të veprës penale Marjeta Lala, Amelja Lala, Emiljo Lala, Enis Lala, Dionisa Lala, Sahadete Lala, Ilir Lala dhe Grisilda Lala.

**1.2.** Siç u parashtrua edhe më lart, nga ana e policisë gjyqësore është administruar pranë ASHK Durrës praktika e të gjithë dokumentacionit që ka shërbyer për legalizimin e ndërtimit pa leje pranë ALUIZNI-T Durrës dhe regjistrimin e pronës në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës. Nga verifikimi i dokumentacionit të sekuestruar rezulton edhe një dokument “*Plan Rilevimi i firmosur nga (ing Vasil Gjoni e shkruar me kompjuter) vendosur vula J&F Archictetural Designer sh.p.k dhe firma e cila është firma e shtetases Nevjana Isufi*”.

I pyetur për sa më sipër, shtetasi Vasil Gjoni i pyetur lidhur me faktin nëse e ka firmosur ose jo këtë Plan Rilevimi, ka deklaruar se nga ana e tij as nuk është përpiluar dhe as nuk ishte firmosur një dokument i tillë dhe se Nevjana në mënyrë të kundraligjshme ka vendosur firmën poshtë emrit të tij duke përdorur emrin në dokumentat e hartuara prej saj.

Nga hetimet rezulton se nga ana e të pandehurës Nevjana Isufi me qëllim plotësimin e dokumentave standarde për regjistrimin e pasurisë së kërkueses Sahadete Lala është përgatitur edhe dokumenti i titulluar “Plan rilevimi”, i cili sipas ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” është përcaktuar se: “Plan rilevimi” është dokumenti që tregon paraqitjen hartografike të një sipërfaqeje të kufizuar të tokës, në përputhje me rregullat dhe standardet zyrtare për krijimin e hartës kadastrale. Përgatitja e tij kryhet nga ana e specialistit topograf të licencuar për matjen hartografike të sipërfaqes së tokës dhe ndërtesës, specialist i cili duhet të ketë njohuritë e posaçme dhe liçesimin përkatës për të kryer vetë, veprim i cili nuk mund të delegohet.

Nga ana e shtetasës Nevjana Isufi nuk është mbajtur parasyshë ligji përkatës, por është kryer veprimtaria e prodhimit dhe nënshkrimit të Plan Rilevimit nga persona të tjerë të palicencuar për kryerjen e Plan Rilevimit duke prodhuar në këtë mënyrë një dokument, i cili i është paraqitur një organi shtetëror në këtë rast ZVRPP Durrës, por i përgatitur dhe firmosur nga ana e shtetasës Nevjana Isufi, ndërkohë që emri i Ing është vendosur ai i shtetasit Vasil Gjoni.

Liçensa përkufizohet si një e drejtë individuale, e cila është përcaktuar në Ligjin Nr.10081, datë 23.2.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” si vijon: "Licencë" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të." Gjithashtu, në nenet 6,7,8,9,10 e në vijim përcaktohen në mënyrë të specifikuar, kushtet për pajisjen, mënyrën e marrjes, përdorimit dhe parimeve të shfrytëzimit të Licensës si një e mirë publike, e cila është autorizuar në një mënyrë të caktuar për tu përdorur nga ana e Autoritetit licensues.

Nisur nga sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e saj shtetasja Nevjana Isufi ka konsumuar elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal pasi ka përdorur emrin dhe titullin e një personi tjetër në mënyrë të kundraligjshme.

Vlen të theksohet se nga ana e jone është hetuar edhe në lidhje me faktin nëse ndonjë person me njohuri të posaçme i tillë si inxhinere konstruktore, etj, mund të kishte verifikuar dhe certifikuar qëndrueshmërinë konstruktive të objektit të mesiperm. Mirepo nga aktet e administruara në dojen hetimore nuk rezultoi që të jete bere ndonjë certifikim i tillë nga ndonjë inxhinier konstruktore, si dhe një gjë e tillë nuk kërkohej as nga ligji. Konkretisht neni 27 i Ligjit Nr. 9482, Datë 03.04.2006 “Për Legalizimin dhe Integrimin e Ndertimeve pa leje” parashikon: *Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin: pika ë) akt-ekspertizë nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate.* Pra sipas kërkesave të këtij ligji, për rastin konkret dhe për të gjitha ndërtimet deri në katë kate nuk kërkohej asnjë lloj verifikimi nga një ekspert i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit por mjaftohej vetëm me një deklaratë personale që mund të bëjë vetë personi që ka në disponim ndërtimin pa leje se merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë që mund të vijë (neni 27 pika “dh” e ligjit nr. 9482, dt. 03.04.2006: *Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin:.... deklaratën personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, si pasojë e faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit*). Në këto kushte dokumentacioni për legalizimin e banesës pa leje ka qenë formalisht i rregullt dhe nuk mund të merret në përgjegjësi ndonjë punonjës i ALUIZNI-t Durrës në lidhje me legalizimin e tij si dhe nuk rezultoi se ndonjë person me njohuri të posaçme në fushën e konstruksionit të ndërtimit të kete certifikuar si të qëndrueshem kete objekt.

**2. Objekti i banimit 6-katësh, pallati nr.1650, (Pallati i Konomëve), afër ish-“Kryqit të Kuq”, lagjia nr.18, Durrës, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetasit Eduart Reçi, Dolora Reçi, Kristi Reçi, Klaus Reçi, Rozeta Meçaj, Diena Karanxhaj dhe Esiela Karanxhaj.**

Nga hetimet e zhvilluara rezuloi se ky objekt fillimisht është projektuar për pesë kate dhe është ndërtuar në periudhën viti 1993 - 1996, sipas lejes së ndërtimit me Nr. 4/10/93 Prot, (Vendim i KRRT Nr.11 datë 22.09.1993) për “Objektin 5 katësh”, lëshuar në emër të subjektit ndërtues Vasil Muka, me investitor shtetasin Perikli Konomi. Leja e ndërtimit për këtë objekt, është miratuar godinë banimi e përbashkët me pesë kate, kati i parë garazh dhe dyqane. Mirëpo ky objekt për shkak të mosmarrëveshjeve midis investitorit dhe subjektit ndërtues, nuk është ndërtuar nga shtetasi Vasil Muka por nga Ing. Zylfi Xhelili, i cili ka zbatuar të gjithë punimet e ndërtimit deri në katin e pestë.

Më pas, në vitin 1996, shtetasi Perikli Konomi, i është drejtuar me një kërkesë Këshillit të Rrethit Durrës, për shtimin e një kati ndërtim mbi objektin ekzistues, kërkesë e cila është miratuar dhe është lëshuar Leje Ndërtimi Nr. 8/10/96 (Vendim i KRRT Nr.9 datë 27.09.1996), për objektin “Banesë 5 katëshe – shtesë kati i 6”, lëshuar në emër të subjektit ndërtues Selim Ushina. Pas përfundimit të ndërtimit, objekti rezulton i regjistruar pranë ASHK Durrës, me Nr. Pasurie 16/247, në ZK 8511, por për këtë pasuri për shkak të mungesës së disa akteve dhe të aktit të kolaudimit të objektit, është vendosur kufizim i pasurive, i cili me urdhërin Nr.5702 datë 21.11.2012, është lënë përsëri në fuqi për të njëjtin shkak, për pasuritë e shtetasit Perikli Konomi, ndërsa për shtetasit e tjerë që kanë blerë apartamente në këtë objekt kufizimi i pasurive është hequr.

Në interes të hetimit nga ana jonë janë marrë dhe janë administruar me procesverbal të rregullt, kopje të dokumentave të gjendura pranë Arkivës së Këshillit të Rrethit Durrës dhe pranë ASHK Durrës, lidhur me këtë objekt si më poshtë:

- Leja e ndërtimit e tipit Formular Nr.1 me Nr.Prot.4/10/93, pa vulë.
- Planimetria e objektit, pa vulë.
- Kërkesë për shtesë kati.
- Leje ndërtimi, pa vulë, pa datë dhe Nr.prot.
- Vendimi Nr.9 datë 19 e 27.09.1996 i KRRT Durrës.
- Procesverbal i Urbanistikës Bashkia Durrës, për kontrollin e ushtruar në objektin e Perikli Konomi, nënshkruar nga Inxhinier Sabri Kalatsi.
- Kërkesë Këshillit të Rrethit Durrës, për shtimin e katit të gjashtë, Nr.1030 datë 26.08.1996.
- Projekt shtesë kati 6, autor Shyqyri Krymbi.
- Plan rivelimi.
- Kartela të pasurive të apartamenteve në këtë pallat.
- Vërtetim hipotekor Nr.7387 datë 03.01.1996, për pasurinë dyqan i katit përdhe Nr.16/247, ZK 8511.
- Urdhër regjistrimi me Nr.5702 datë 21.11.2012.

Në interes të hetimit të kësaj çështjeje penale, janë thirrur dhe pyetur banorët e këtij pallati, shtetasit Leonard Taçe, Violeta Dodaj, Ajet Meçja, Leonard Konomi, Edison Konomi, Perikli Konomi, etj.. Nga të dhënat e marra rezulton se investitor në ndërtimin e këtij pallati ka qenë shtetasi Perikli Konomi, i cili ka blerë truallin dhe më pas në këtë objekt ka marrë leje ndërtimi me ndërtues Vasil Muka, i cili ka kryer punime vetëm për hapjen e bazamentit të ndërtimit dhe ka ndërprerë punimet pasi nuk janë marrë vesh me investitorin në lidhje me pagesat. Më pas ndërtimin e objektit e ka marrë përsiper dhe e ka kryer kompania e ndërtimit të shtetasit Zylfi Xhelili duke përfunduar punimet sipas lejes së ndërtimit. Më pas, për katin shtesë ka marrë leje me ndërtues shtetasin Selim Ushina. Nga ana e shtetasit Ajet Meçja

pretendohet se mbi katin e gjashtë është bërë shtesë në formë papafingo me dy apartamente ku banonin djemtë e Perikliut. Po kështu pretendohet se nga ana e Perikliut janë bërë punime edhe në ambientet e katit të parë duke hequr mure dhe zgjeruar lokalin dhe një pjesë të parkimit e ka bërë fabrikë akulli. Nga ana e tyre shtetasit Perikli, Leonard dhe Edison Konomi deklarojnë ndër të tjera se në lidhje me papafingot e bëra, ato kanë qenë në projektin e miratuar me leje ndërtimi, ku është përcaktuar me çati të shfrytëzueshme. Ndërsa në lidhje me punimet e bëra në katin e parë ata deklarojnë se gjatë kohës që ka funksionuar si lokal “Ice Club”, nuk kanë bërë punime që çënojnë konstruksionin e objektit.

Më tej, në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore dhe është administruar dokumentacion, të tilla si:

- Këqyrja e vendit të ngjarjes së bashku me tabelat fotografike përkatëse.
- Marrja e mostrave të hekurit dhe betonit në rrënojat e këtij objekti.
- Analizat laboratorike të cilësisë së hekurit dhe betonit.
- Informacion nga Instituti i Gjeoshkencave Energjisë, Ujit dhe Mjedisit lidhur me lëkundjet e tërmetit të datës 26.11.2019.
- Kryerja e një ekspertimi lidhur me Studimin Sizmiologjik të sheshit të ndërtimit.
- Kryerja e një ekspertimi lidhur me Studimi Gjeologjik të sheshit të ndërtimit.
- Kryerja e një ekspertimi Inxhinieriko Teknik lidhur me shkaqet e shembjes së objektit.
- Dokumentacioni tekniko-ligjor i objektit, etj.

Nga Akt Ekspertimi Teknik Korrik 2020, ka rezultuar ndër të tjera:

Referuar projektit konstruktiv të pallatit nr.1650, afër “Kryqit të Kuq”, Lagjia nr. 18, Durrës, hartuar nga B.S.P. Durrës, rezulton që ky projekt është një ripunim i Tip 82/2. Pallati nr.1650, afër “Kryqit të Kuq”, është realizuar sipas një projekti për ndërtesë 5 kat me strukturë mbajtëse ramë beton arme monolite. Pra, elementët beton arme janë të derdhur në vend. Marka e betonit referuar në projekt është M-200 (për themelet M-150). Duke konsideruar uljen e markës së betonit, është rritur ndjeshëm armimi i kolonave. Distancat midis kolona (nga aksi në aksi) ndryshon nga projekti original.

Sipas projektit të pallatit nr.1650, afër “Kryqit të Kuq”, themelet e strukturës janë të realizuar me plinta me dy shkallëzime, me dimensione në plan 250x250cm dhe 140x140cm, me lartësi 55cm (PL-1) për kolonat perimetrale të pozicionuara në veri dhe në jug, më tej 280x280cm dhe 160x160cm, me lartësi 55cm (PL-2) për kolonat e mesit, 280x315cm dhe 160x195cm (PL-3), 280x305cm dhe 160x185cm, me lartësi 55cm (PL-3a) për kolonat ngjitur me objektin 5 katësh të ndodhur në fasadën perëndimore. Plintat perimetral lidhen në kokë me tra beton arme me dimensione (bxh) 30x40cm. Plintat janë betonuar me beton M-150. Thellësia e vendosjes së plintit është -2.30m nga sipërfaqja e terrenit natyror. .... Bazuar në Procesverbalin e Rikqyrjes së Vendit të Ngjarjes themeli tip plint beton arme nën kolonën të specifikuar në fig.15 dhe siç tregohet në fig.14, është me dy shkallëzime me dimensione përkatësisht 200x200x60cm dhe shkallëzimi i dytë 140x140x60cm. Pra, dimensionet e themeleve nuk janë zbatuar sipas atyre të përcaktuar në projektin e zbatimit.

Të gjitha kolonat janë të vendosura sipas akseve paralel, dhe janë me dimensione 30x40cm. Armimi i tyre varion në bazë të pozicionit ku janë vendosur. Nga matjet në terren të sasisë së armaturës dhe diametrave të shufrave, nga grupi i ekspertëve konstatohet ndryshim midis projektit dhe zbatimit të ndërtesës. Në projektin e ripunuar mungon detaji i armimit të kolonave, por duke ju referuar fitilave të kolonave në katin përdhe në projekt dhe atyre të ndodhura në sheshin e ndërtimit (nga këqyrja e sheshit nga grupi i ekspertëve në datat 26.05.2020 dhe 14.07.2020), vihet re se në projekt fitilat e kolonave në plintin (PL-1) janë 10φ20+2φ16 dhe ato në plintat e tjerë 10φ24+2φ16, ndërsa në fakt fitilat e kolonave rezultojnë të gjitha 10φ20+2φ16.

Projekti i shtesës së katit të gjashtë me mbulesë me çati

Në objektin pallat nr.1650, afër “Kryqit të Kuq”, ndodhur në lagjen 18, Durrës, është bërë një shtesë kati, sipas Lejes së ndërtimit me Vendim K.RR.T. të Rrethit Durrës, Nr.9, datë

27.09.1996, për objektin “Banesë 1 katëshe, shtesë kati i gjashtë”, dhënë zbatuesit të punimeve Selim Ushina, me financues Perikli Konomi, nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të Rrethit Z. Vasillaq Papaj. Për këtë shtesë kati është hartuar projekti i zbatimit nga Ing. Shyqyri Krymbi, me licencë nr. A-0096. Siç shikohet në shënimet e projektit të zbatimit, shtesa e katit të pestë (kati i gjashtë + çati) ngrihet mbi seksionin ekzistues. Për këtë kat ruhet arkitektura e godinës si dhe punimet e rifiniturës. Mbulesa është me çati dekorative, me katër pjerrësi, mbuluar me tjegulla vendi. Lartësia e katit shtesë është e njëjtë me katet e mëposhtme, ndërsa çatia ka lartësinë (kulmi i çatisë) 2.54m. Referuar pamjeve të ortofotove, vihet re se çatia nuk është zbatuar në të gjithë sipërfaqen e katit të gjashtë, duke zvogëluar sipërfaqen e mbulimit të saj përgjatë perimetrit të objektit. Ajo është mbështetur mbi mure perimetral të ndërtuara me tulla me vrima.

#### Struktura mbajtëse e shtesës

Shtesa e katit të gjashtë+çati është realizuar sipas një projekti për një strukturë mbajtëse ramë beton arme monolite. Janë ruajtur të njëjtat akse kolonash si në katet e mëposhtme (të ndërtesës 5 kate). Të gjitha kolonat janë me dimensione 30x40cm. Armimi i tyre varion në bazë të pozicionit ku janë vendosur. Në shënimet teknike të fletës së paraqitur në fig.27, e konkretisht në pikat 1 dhe 2 te saj vihet re se sipas projektuesit Ing. Shyqyri Krymbi, elementët mbajtës të ndërtesës 5 kate janë llogaritur duke marrë në konsideratë ngarkesat e objektit për 6 kate. Por për këtë nuk gjendet asnjë shënim apo referencë në projektin e zbatimit të ndërtesës 5 kate të hartuar nga B.S.P. Durrës.

#### Soletat

Bazuar në projektin teknik të shtesës së katit (siç vihet re në fig.27), soletat janë të tipit të parapërgatitura me vrima. Në dokumentet e administruara në dosje, nuk gjendet projekti i detajuar i çatisë hartuar nga projektuesi (detaje të konstruksionit mbajtës të çatisë). Duke ju referuar pikës 2 të lartëcituar (marre nga shënimet e fig.27), planit të strukturave të katit tip (fig., tarracës së ndërtesës 5 kate dhe soletës në kuotën +18.32m (tarracës së katit shtesë), vihet re se ndryshon ngarkesa e normuar. Pra, soleta e tarracës së ndërtesës 5 kate (e cila më pas ka shërbyer si dysheme për katin shtesë) është projektuar nga B.S.P. Durrës për një ngarkesë të normuar  $P_n=75\text{kg/cm}^2$  (që i përgjigjet ngarkesës për soleta çatie dhe nënçatie të pashfrytëzueshme) dhe jo për një ngarkesë  $P_n=150\text{kg/cm}^2$  (që i përgjigjet ngarkesës për soletë të shfrytëzueshme për banim), siç shënohet në projektin e shtesës hartuar nga Ing. Shyqyri Krymbi.

Raporti mbi Kushtet Gjeologo-Inxhinierike të sheshit të ndërtimit ku ka qenë ndërtuar pallati nr.1650, afër Kryqit të Kuq, konstatojmë se themelet e ndërtesës kanë qenë të mbështetura në një taban (formacion gjeologjik) me karakteristika fiziko mekanike mjaft të dobëta dhe me prezencë të lartë të ujërave të kripura dhe agresive karshi hekurit dhe betonit. Sa më sipër, në këto raste për ndërtimin e ndërtesave shumë-katëshe është e domosdoshme marrja në konsideratë dhe realizimi i masave përmirësuese të posaçme me qëllim rritjen e aftësisë mbajtëse dhe shpërndarjen uniforme të ngarkesave në taban, por edhe në zgjedhjen e klasës së betonit i ndodhur në prani të ujërave agresive.

Grupi i ekspertëve, duke ju referuar këtyre provave laboratorike si dhe këqyrjes së mostrave të marra në objekt, shpreh mendimin se: Karakteristikat e betonit dhe të çelikut të përdorur për ndërtimin e strukturës beton arme të objektit “Pallati nr.1650, 6 kate afër Kryqit të Kuq”, lagjia 18, Durrës, plotësojnë kërkesat e specifikuara në projektin e zbatimit.

Armimi i kolonave të katit përdhe që rezulton sipas faktit (nga këqyrja në vend) tregon që nuk është respektuar armimi i kolonave dhënë sipas projektit të administruar në dosje për këtë objekt. Tabela e mësipërme evidenton faktin që, duke krahasuar armimin që rezulton nga modelimi strukturor për objektin 5 kat dhe 6 kat, armimi sipas faktit është konsiderueshëm më i vogël. Kjo diferencë e armaturës së hekurit në kollonat e objektit, ka ndikuar në uljen e aftësisë mbajtëse të strukturës te objektit 5 kat dhe akoma me tepër me shtesën e katit të gjashtë.

Pas përfundimit të punimeve të shtesës së katit të gjashtë, në zbatim të ligjit nr. 7693, datë 06.04.1993 “Për urbanistikën” i ndryshuar, nga Seksioni i Urbanistikës Durrës është mbajtur



një Proces verbal, në datën 08.08.1999, mbi kontrollin e ushtruar në objektin Perikli Konomi shtesë kati me 6 (gjashtë) kate të pronarit Perikli Konomi, mbajtur nga Inxhiner Sabri Kalatsi, me anë të së cilës vërtetohet se objekti është ndërtuar si karabina, duke lejuar investitorin të kryejë veprimet e nevojshme ligjore për njohjen e tij. Referuar dokumenteve të administruara në dosjen hetimore rezulton se pronarët e truallit kanë ndjekur procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 7693, datë 06.04.1993 “Për urbanistikën” i ndryshuar, për t’u pajisur me Leje Ndërtimi si për ndërtesën 5 kat, ashtu edhe për shtesën e katit të gjashtë me mbulesë çatie.

Në dosjen hetimore, gjenden disa dokumente tekniko-ligjore në zbatim të ligjit nr. 7693, datë 06.04.1993 “Për urbanistikën” i ndryshuar, për t’u pajisur me Leje Ndërtimi si për ndërtesën 5 kat, ashtu edhe për shtesën e katit të gjashtë me mbulesë çatie. Sa i përket procesit të zbatimit konstatohen mangësi në dokumentacion në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.7720, dt. 14.06.1993, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” ndryshuar dhe Kushtet Teknike të Zbatimit. Si konkluzion, Pallati nr.1650, 6 kat afër Kryqit të Kuq, lagjia 18, Durrës nuk është Zbatuar dhe Kolauduar në përputhje me kërkesat e kuadrin ligjor në fuqi në vendin tonë në kohën e kryerjes së ndërtimit.

Sa më sipër, mos respektimi i projektit konstruktiv gjatë zbatimit të objektit 5 kat dhe projektimi jo i saktë i katit shtesë, duke mos marrë në konsideratë mangësitë e zbatimit të objektit 5 kat apo masa të nevojshme përforsimi, kanë qenë faktor deciziv në shembjen e objektit në veprimin sizmik të shkaktuar nga tërmeti i 26 Nëntor 2019.

#### Konkluzion

Referuar argumenteve të mësipërme dhe rezultateve të analizës strukturore, rezulton që shkaqet kryesore që kanë sjellë shembjen e “Pallatit 6 katësh afër Kryqit të Kuq, Lagjia 18, Durrës” kanë qenë:

Mosrespektimi i projektit konstruktiv gjatë zbatimit të objektit 5 kat, veçanërisht sasia e pamjaftueshme e armaturës së hekurit në kolonat e katit përdhe.

Kati shtesë (me leje ndertimi) është projektuar për t’u ndërtuar mbi një strukturë që nuk ishte llogaritur për të përballuar ngarkesa shtesë vertikale, të cilat kanë sjellë rritjen e peshës/masës së saj dhe për rrjedhojë rritjen e forcave sizmike që kanë vepruar gjatë tërmetit të 26 Nëntor 2019.

Nisur nga sa më sipër në lidhje me shkaqet e shembjes së pallatit 6 katësh afër “Kryqit të Kuq”, lagjia 18, Durrës, rezulton se pronarët e truallit kanë ndjekur procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 7693, datë 06.04.1993 “Për urbanistikën” i ndryshuar, për t’u pajisur me Leje Ndërtimi si për ndërtesën 5 kat, ashtu edhe për shtesën e katit të gjashtë me mbulesë çatie.

Nga ana tjetër nga hetimi rezultoi e provuar se shembja e këtij objekti ka ardhur si shkak i veprimeve apo mosveprimeve të shtetasve të mëposhtëm:

- Shtetasi Zylfi Xhelili, me detyrë inxhiner dhe hartues i planimetrisë së pesë kateve si dhe zbatues i ndërtimit të objektit 5 kate, i cili nuk ka respektuar projektin konstruktiv gjatë zbatimit të objektit 5 kat, veçanërisht nëpërmjet sasisë së pamjaftueshme të armaturës së hekurit në kolonat e katit përdhe.

- Shtetasi Shyqyri Krymbi me detyrë inxhiner projektues gjatë hartimit të projektit të shtesës mbi katin e pestë (kati i gjashtë + çati) nuk ka llogaritur saktë për të përballuar ngarkesa shtesë vertikale, të cilat kanë sjellë rritjen e peshës/masës së saj dhe për rrjedhojë rritjen e forcave sizmike që kanë vepruar gjatë tërmetit të 26 Nëntor 2019 dhe

- Shtetasi Selim Ushina, me detyrë inxhiner dhe ndërtuesi i objektit, që lidhet me katin shtesë të objektit dhe konkretisht katin e gjashtë + çati, ka ndërtuar pa marrë parasysh standardet dhe rregullat teknike në fushën e ndërtimit.

Siç shikohet edhe më lart, shtetasit Zylfi Xhelili, Shyqyri Krymbi dhe Selim Ushina me dashje direkte e kanë kryer projektimin dhe ndërtimin e objektit pesë katësh, më pas edhe të katit shtesë + çatisë në kundërshtim me kushtet teknike të vendosura të Republikës së Shqipërisë (KPT dhe KTZ), për projektimin dhe zbatimin e punimeve në ndërtim. Keta shtetas duke besuar tek aftësitë e tyre në projektimin dhe ndërtimin e këtij objekti, sidhe duke

besuar se objekti mund të jetë i qëndrueshëm nga pikëpamja teknike, kane arritur te projektojnë dhe zbatojnë ndertimin e nje objekti, I cili me renien e termetit te dates 26.11.2019, ka sjelle si pasojë vdekjen e shtatë personave, te cilet banonin aty. Ky termet sipas akteve ne fuqi ne R. Shqiperise ishte I pritshem dhe I parashikueshem ne standartet e ndertimit. Pasojat kanë ardhur nga pakujdesia, pasi ata nuk i kanë parashikuar pasojat që mund të vinin, megjithëse sipas rrethanave në të cilat është kryer projektimi dhe ndërtimi ata duhet ti parashikonin ato. Për këtë arsye me veprimet e tyre ata kanë konsumuar elementët e veprës penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal për të shtatë viktimat. Mirëpo nga verifikimet e kryera e konkretisht nga çerifikatat e vdekjes të administruara në dosjen hetimore, rezultoi se shtetasit Zylfi Xhelili, Shyqyri Krymbi dhe Selim Ushina kanë vdekur dhe si të tillë, bazuar në kërkesat e nenit 328/1/ë të Kodit të Procedurës Penale hetimet ndaj këtyre shtetasve nuk mund të vazhdojnë dhe duhet të pushohen.

Se fundi rezultoi se edhe shtetasi Sabri Kalatsi, inxhiner dhe Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës ne kundershtrim me ligjin ka nënshkruar Lejen e shfrytëzimit dt. 24.11.199 për objektin e mësipërm, pa pasur me pare te gjithe dokumentacionin tekniko-ligjor. Me keto veprime te kryera ky shtetas ka kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, por sic shihet edhe me lart, kjo vepër penale është kryer në vitin 1999 (përpara më shumë se dhjetë vitesh) dhe bazuar në kërkesat e nenit 66/c të Kodit Penal nuk mund të ushtrohet ndjekje penale për këtë vepër kur kanë kaluar më shumë se dhjetë vite nga kryerja e saj.

**3. Objekti “Hotel Tropikal”, lagjia nr.13, Durrës,** nga shembja e të cilit kanë humbur jetën dy shtetas kosovarë (dy vëllezërit Shemsedin Abazi dhe Isah Abazi), si dhe kanë pësuar dëmtime të rënda pronari Abdulla Osmani dhe bashkëshortja e tij.

Ky objekt është ndërtuar në mënyrë individuale nga investitori Abdulla Osmani. Për këtë objekt është marrë leje ndërtimi Nr.04 datë 17.06.2005 nga KRRT-ja e Bashkisë Durrës, për të ndërtuar një objekt 4 katësh dhe një kat papafingo dhe të një objekti tjetër katër katësh me funksion banimi. Në këtë vendim është i përcaktuar përballimi nga ndërtimi i një intensiteti prej 9 ballë.

Nga studimi i Lejes së ndërtimit rezulton se: Leja e ndërtimit është marrë për ndërtimin e dy banesave (një në pronësi të shtetasit Abdulla Osmani dhe tjetra në pronësi të shtetasit Seit Osmani) nga të cilat nga tërmeti i datës 26.11.2019, është shkatërruar vetëm njëra prej ndërtesave (ish-“Hotel Tropikal” në pronësi të shtetasit Abdulla Osmani) duke sjellë si pasojë dhe vdekjen e dy shtetasve kosovarë dhe plagosjen e rëndë të pronarit dhe bashkëshortes së tij. Në këtë leje ndërtimi përcaktohet se objekti do të ndërtohet nga subjekti “ED-GEST” me nr. License N4860/1 dhe në pikën 8 të lejes citohet:“Objekti i përfunduar të aplikohet neni 77”, pa u cituar ligji që i përket këtij neni.

Një vit mbas dhënies së lejes është marrë edhe Leja e Shfrytëzimit të Objektit e cila ka nr. 3604 Prot datë 15.11.2006. Kjo leje ndërtimi rezulton se është dhënë në zbatim të nenit 77 të Ligjit Nr.8405, datë 17.9.1998 “PËR URBANISTIKËN”, i ndryshuar, i cili parashikonte ndër të tjera “Për ndërtimet e kunderligjshme të bëra deri në kohën e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, veprohet si vijon: .....Për ndërtimet e kryera pa leje nga pronarët në pronën e tyre, kur plotësohen kushtet urbanistike, KRRT vendos për legalizimin e ndërtimit me kushtin e detyrimit të pagesës së gjobës.....

Investitori Abdulla Osmani ka nënshkruar një marrëveshje me shtetasin Malo Estrefi, administratori i shoqërisë “ED-GEST”, datë 22.04.2005, vetë nënshkruesi i marrëveshjes e pranon nënshkrimin e tij, por pohon se nuk ka bërë asnjë punim në objekt. Në muajin Maj të vitit 2006 është bërë edhe një Akt Kolaudimi për objektin, akt i cili është bërë nga inxhinieri Lefter Shuka, i cili është bërë mbas përfundimit të objektit dhe nuk ka ndjekur punimet në objekt gjatë ndërtimit e realizimit të tij. Ky kolaudator pohon se mbi objekt janë

bërë shtesa të tjera nga investitori, si bërja e papafingos kat i plotë për ndërtesën dhe ndërtimin e një papafingoje mbi papafingon që ai e ka kthyer në kat.

Për të bërë legalizimin e kësaj shtese shtetasi Abdulla Osmani, ka paraqitur në ish-Zyrat e Aluizni-t një kërkesë të portokolluar me numrin 2685 dhe datë 18.07.2013, duke kërkuar legalizimin e shtesës anësore dhe të një kati. Kërkesa e tij ka filluar të trajtohet nga ish-Aluizni duke u bërë verifikimet në terren dhe ka ngelur akoma në proces.

Aktiviteti që ushtrohej në këtë objekt, figuron i regjistruar në DRT me emrin tregtar “DULE” shpk dhe NIPT J82401502P.

Në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore dhe është administruar dokumentacion, si:

- Këqyrja e vendit të ngjarjes së bashku me tabelat fotografike përkatëse.
- Marrja e mostrave të hekurit dhe betonit në rrënojat e këtij objekti.
- Analizat laboratorike të cilësisë së hekurit dhe betonit.
- Informacion nga Instituti i Gjeoshkencave Energjisë, Ujit dhe Mjedisit lidhur me lëkundjet e tërmetit të datës 26.11.2019.
- Studimi Sizmiologjik.
- Studimi Gjeologjik i sheshit të ndërtimit.
- Dokumentacioni tekniko ligjor i objektit.
- Si dhe një numër i madh veprimesh të tjera hetimore, si deklarime të personave që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale, etj.

Nga ana jonë me qëllim sqarimin e fakteve nëse Projektimi, Zbatimi, Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i ndërtesës godinës ish-objekti “Hotel Tropikal”, lagjia nr.13, Durrës, kanë qenë në përputhje me kushtet teknike kombëtare dhe kuadrin rregullator ligjor për ndërtimin në RSH si dhe për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë shembjen e ndërtesës është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik.

Nga akt ekspertimi teknik përkatës në lidhje me objektin 5+1 kate, Ish-“Hotel Tropikal”, ka rezultuar ndër të tjera se: *-Referuar Raportit mbi Kushtet Gjeologo-Inxhinierike të sheshit të ndërtimit ku ka qenë ndërtuar “Hotel Tropikal”, konstatojmë themelet e ndërtesës kanë qenë të mbështetura në një taban (formacion gjeologjik) me karakteristika fiziko mekanike mjaft të dobëta, me shumë lagështirë. Gjithashtu, duke analizuar edhe shtresat e tjera poshtë saj konstatojmë pak a shumë të njëjtat formacione të dobëta. Sa më sipër, në këto raste për ndërtimin e ndërtesave shumë katëshe është e domosdoshme marrja në konsideratë dhe realizimi i masave përmirësuese të posaçme me qëllim rritjen e aftësisë mbajtëse dhe shpërndarjen uniforme të ngarkesave në taban.*

*-Sheshi i ndërtimit ku ndodhej “Hotel Tropikal”, bazuar në Hartën e Mikrozonimit Sizmik të rajonit të Durrësit (1985), kategorizohet si një zonë me intensitet sizmik IX ballë dhe si e tillë është një ndër zonat më të rrezikuara të vendit tonë sa i përket rrezikut sizmik. Të dhënat e rrjetit akselometrik (të instaluar në oborrin e Ndërmarrjes së Ujësjellësit në Durrës) pavarësisht se kanë regjistruar vetëm 15 sek e para të ngjarjes sizmike të 26 Nëntorit 2019 konfirmojnë që tërmeti i rënë përkon me rrezikun sizmik të parashikuar në studimet sizmike dhe Hartën e Mikrozonimit të Durrësit.*

*-Konkretisht, ngjarja sizmike e 26 Nëntorit 2019 përkon me rrezikun sizmik për të cilat duhet të projektohen ndërtimet në këtë zonë, që do thotë që ndërtesat e projektuara e të zbatuara në përputhje të plotë të KTP dhe KTZ në vendin tonë, mund të pësojnë dëmtime lokale, në element strukturor ose jo-strukturorë, por duhet të rezistojnë pa u shembur nga një ngjarje e tillë sizmike.*

*-Bazuar në provat laboratorike të kryera nga kompania “ALTEA & GEOSTUDIO 2000”, në dhjetor 2019, rezulton që cilësia (rezistenca) e betonit të përdorur në objekt është e dobët dhe nuk është në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) dhe Kushtet Teknike të Zbatimit (KTZ) aktualisht në vendin tonë. Ky fakt, mund të jetë dhe një nga shkaqet kryesore që kanë sjellë shembjen e Hotel Tropikal, në ngjarjen sizmike të dt. 26.11.2019.*

*-Ndërtimi i kateve shitesë (kati i pestë si kat i plotë, dhe kati i gjashtë si papafingo), duke rritur në këtë mënyrë masën e ndërtesës dhe sforcimet në katet e poshtme të strukturës, ku mendohet për me tepër se betoni ka qenë i një cilësie të dobët. Sic rezulton nga dokumentet në dosje, ky objekt është ndërtuar me faza (jo njëherazi, sipas mundësisë financiare të Investitorëve), duke mos respektuar kushtet e përcaktuara në KTP dhe KTZ.*

Siç shikohet edhe më lart, ndërtimi i objektit është realizuar pa një studim gjeologjik-sizmik, pa projekt konstruksioni dhe objekti në tërësi, pa mbikëqyrje punimesh, pa një libër masash lidhur me volumet e punës dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit, por për efekt të marrjes së lejes së ndërtimit dhe legalizimit, projekti është bërë mbas realizimit të ndërtimit sipas nenit 77 të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”.

Nga ana e ndërtuesit njëkohësisht edhe investitori i cili ka ndërtuar pa leje objektin, duke legalizuar objektin fillimisht në vitin 2006 dhe pas saj sërish ka kryer ndërtim shitesë për të cilin ka aplikuar për leje legalizimi për një kat shitesë por i cili nuk është legalizuar.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së ndërtimit të objektit “Hotel TROPICAL”, lagjia nr.13, Durrës, shtetasi Abdulla Osmani në cilësinë e investitorit dhe ndërtuesit pa leje me veprimet dhe mosveprimet e tij ka konsumuar elementët e veprës penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, në dëm të dy viktimave Shemsedin Abazi dhe Isah Abazi. Shtetasi Abdulla Osmani ka kryer ndërtimin e objektit pesë katësh+papafingo, pa respektuar rregullat dhe normat ligjore në fushën e ndërtimit përsa i përket studimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit ndërtimor, gjë e cila ka sjellë si pasojë shembjen e objektit nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe vdekjen e dy shtetasve të sipërpërmendur që gjendeshin në këtë objekt.

Nga ana e shtetasit Abdulla Osmani pavarësisht se po ndërtonte një objekt ndërtimor pesë katësh+papafingo me funksion social ekonomik “Hotel”, në kundërshtim me ligjin nuk ka pajtuar asnjë specialist të fushës së projektimit dhe ndërtimit me qëllim kryerjen e studimit gjeologjik, sizmik dhe më pas hartimin e projektit konstruktiv të objektit. Po kështu edhe gjatë zbatimit të punimeve nuk është mbajtur asnjë lloj dokumentacioni për cilësinë e materialeve të ndërtimit, cilësinë e punimeve dhe mbi volumet e punimeve të kryera në këtë objekt, (libër masash mbi punimet e kryera dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit të përdorur, situacionet e punimeve, akt kolaudimi apo ekspertimi teknik lidhur me qëndrueshmërinë sipas parashikimeve ligjore, etj).

Shtetasi Abdulla Osmani me dashje direkte e ka kryer ndërtimin e objektit në mënyrë të kundraligjshme dhe pa lejen e organeve kompetente, duke besuar tek aftësitë e tij apo personave që kanë marrë pjesë në ndërtimin e këtij objekti, se objekti mund të jetë i qëndrueshem nga pikëpamja teknike, por pasojat e ardhura nga shembja e ndërtesës së ndërtuar nga vetë ai kanë ardhur nga pakujdesia, pasi ai nuk i ka parashikuar pasojat që mund të vinin, megjithëse sipas rrethanave në të cilat është kryer ndërtimi ai duhet ti parashikonte, (ai vetë dhe familja e tij banonin në këtë objekt, në të njëjtin objekt). Shtetasi Abdulla Osmani, jo vetëm nuk i është përmbajtur legjislacionit në fushën e ndërtimit lidhur me KTP e KTZ, por edhe për legalizimin e objektit ka përdorur në mënyrë fiktive dokumentet për pajisje me leje ndërtimi, (siç cituam edhe më sipër dokumentat e hartuara e të gjendura janë vetëm për të veshur anën formale të dokumentacionit tekniko ligjor, por ato nuk janë dokumente që i përgjigjen realitetit sipas kohës dhe përmbajtjes për objektin, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998, neni 77, “Për Urbanistikën në RSH”).

Nisur nga sa më sipër dhe mbështetur në faktet dhe provat e administruara në funksion të hetimeve të procedimit penal rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij i pandehuri Abdulla Osmani ka konsumuar elementët e veprës penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal në dëm të viktimave Shemsedin Abazi dhe Isah Abazi.

Se fundi rezultoi se edhe shtetasi Lefter Shuka, inxhinier ndërtimi, i cili ka bërë Akt Kolaudimi për objektin, ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin dhe përmbushjen e detyrës, duke bërë një akt kolaudimi shumë kohë mbas përfundimit të objektit dhe nuk ka ndjekur punimet në objekt gjatë ndërtimit e realizimit të tij. Me keto veprime të kryera ky

shtetas ka kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, por sic shihet edhe me lart, kjo vepër penale është kryer në vitin 2006 (përpara më shumë se dhjetë vitesh) dhe bazuar në kërkesat e nenit 66/c të Kodit Penal nuk mund të ushtrohet ndjekje penale për këtë vepër kur kanë kaluar më shumë se dhjetë vite nga kryerja e saj.

**4. Objekti “Hotel Mira Mare”, lagjia nr.13, Durrës,** nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetasit Sotiraq Misha dhe Evjola Broshka. Ky objekt ishte ndërtuar pa lejen e organeve kompetente dhe për të cilin pronari i tij shtetasi Ruzhdi Xheka kishte aplikuar duke plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizim në vitin 2005 dhe më pas edhe me një formular shtesë në vitin 2006. Nga ana e ALUIZNI-T Durrës, objekti është legalizuar në datën 20.12.2019.

Nga ana e policisë gjyqësore janë administruar pranë ASHK Durrës praktika e të gjithë dokumentacionit që ka shërbyer për legalizimin e ndërtimit pa leje pranë ALUIZNI-T Durrës.

Nga verifikimi i dosjes së Aluizni-t janë marrë në cilësinë e provës materiale dokumentat si më poshtë vijon.

- Formulari i Vetëdeklarimit Nr. 1564 datë 03.03.2005, firmosur nga pronari i objektit Ruzhdi Xheka.
- Vetëdeklarim për legalizimin e objektit nr. 3439 datë 12.09.2006, ku në të është pasqyruar viti i ndërtimit të objektit 20.09.1998, firmosur nga pronari i objektit Ruzhdi Xheka.
- Çertifikatë familjare e shtetasit Ruzhdi Xheka e datës 11.09.2006.
- Gent Plan i datës 18.09.2010 për të pesë katet e ndërtesës, firmosur nga Sejdi Dauti, Luan Sulejmani dhe verifikuar nga Adrian Tanushi specialist terreni në ASHK-Durrës, ku verifikimi është bërë në datën 03.12.2018.
- Procesverbal Verifikimi në terren i datës 3.12.2018, firmosur nga specialist i terrenit Ardian Tanushi dhe hartografi Flavio Rexho.
- Gen Plan i datës 08.02.2019, firmosur nga Flavio Rexho hartograf, në pozcoinin e Përgjegjës të Sektorit të Hartografisë, Elvis Pengili Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë dhe drejtori Arben Isaku.
- Planimetritë e kateve të ndërtesës, firmosur nga Arben Isaku, Flavio Rexho dhe Ardian Tanushi të datës 06.02.2019.
- Leja e legalizimit nr. 283837 datë 20.12.2019 në emër të Ruzhdi Xheka, firmosur nga Aldo Dakovelli dhe Arben Isaku.
- Deklaratë Personale e datës 02.02.2017, firmosur nga deklaruesi Ruzhdi Xheka i cili sipas formularit deklaroi se mbart mbi vete koston e dëmtimeve që vijnë si pasojë e punimeve të kryera në objekt prej shkaqeve natyrore, kur nuk janë respektuar kushtet teknike, përdorimit të objektit ndërhyrjet në rikonstruksionin mbajtës të objektit.
- Fotokopje e njehsuar me origjinalin e Çertifikatës së pronësisë së truallit me nr.1528794 datë 12.10.2017 me pronar Arjan Ruzhdi Xheka dhe hartë treguese e lëshuar nga regjistruet Ardjan Kona.
- Vendim për kualifikimin e ndërtimit informal me nr. 31120 datë 14.12.2018, firmosur nga Aldo Dakavelli dhe Arben Isaku.
- Shkresë nr. 375 datë 10.11.2017 e Aluizni-t, drejtuar ZVRPP Durrës, bashkëlidhur harta treguese me vulë lidhëse si dhe kartelat e pasurive me nr. 8/29 dhe 8/28 pa vulë lidhëse.
- Shkresë nr.1942 datë 19.02.2019 për dërgimin e dosjes për regjistrim në ZVRPP Durrës, firmosur nga drejtori Arben Isaku.
- Shkresa nr.1941 datë 19.02.2019 për njoftimin për legalizim në Bashkinë e Durrësit për subjektin Ruzhdi Xheka, firmosur nga Arben Isaku.

- Të gjithë formularët e pagesave sipas deklaratave dhe mënyrës së pagesës së bërë nga aplikuesi.
- Fotokopje Akt Ekspertizë e Godinë sociale ekonomike pesë kate, firmosur ing. Shyqyri Qemal Krymbi e Janar 2011, fotokopje e firmosur nga kryetari i komisionit Stavri Ristani, tetë fletë.
- Fotografitë e objektit pa datë.

Po kështu në kuadër të hetimit të çështjes së mësipërme penale, është marrë dhe sekuestruar e gjithë praktika e dokumentave që kanë shërbyer për regjistrimin e objektit të mësipërm pranë ZVRPP Durrës, nga e cila rezulton si më poshtë vijon:

- Referenca Nr. 00037504, ZK.8518, Nr. Pas. 8/189/Nd, vol.133, fq.208 me pronar Ruzhdi Xheka.
- Kartelë pasurie ZK.8518, Nr. Pas. 8/189/Nd, vol.133, fq.208 me pronar Ruzhdi Xheka.
- Harta treguese e regjistrimit me shënime me shkrim dore nga pas dhe mban datën 25.03.2019.
- Kërkesa dhe fatura pagese në emër të shtetasit Ruzhdi Xheka.
- Shkresë nr.1942 datë 19.02.2019 për dërgimin e dosjes për regjistrimi në ZVRPP Durrës.
- Objekti është regjistruar në Hipotekë nëpërmjetë ALUIZNI-T me leje Legalizimi nr. 283837 datë 20.12.2018, godinë pesë kate mbi tokë me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 557m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 308m<sup>2</sup>, për aktivitet 1434m<sup>2</sup>.
- Gen Plani është firmosur nga Flavio Rexho në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Hartografisë dhe Përpunimit të Informacionit Gjeografik në ALUIZNI Durrës, si dhe planimetritë e kateve të ndërtimit, përditësimi është bërë nga M.Tanushi, firmosur nga drejtori i Aluizni-t Arben Isaku.
- Plan Rilevimi është përgatitur nga subjekti-ING. 2018, Luli Pengili.
- Licensë Nr. 6872 e subjektit ING 2018.
- Kartelë pasurie ZK.8518, Nr. Pas. 8/29/Nd, vol.15, fq.227 me pronar Arjan Ruzhdi Xheka.

Më tej, në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore si:

- Këqyrja e vendit të ngjarjes së bashku me tabelat fotografike përkatëse.
- Marrja e mostrave të hekurit dhe betonit në rrënojat e këtij objekti.
- Analizat laboratorike të cilësisë së hekurit dhe betonit.
- Informacion nga Instituti i Gjeoshkencave Energjisë, Ujit dhe Mjedisit lidhur me lëkundjet e tërmetit të datës 26.11.2019.
- Studimi Sizmiologjik.
- Studimi Gjeologjik i sheshit të ndërtimit.
- Dokumentacioni tekniko ligjor i objektit.
- Si dhe një numër i madh veprimesh të tjera hetimore, si deklarime të personave që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale, etj.

Nga ana jonë me qëllim sqarimin e fakteve nëse, Projektimi, Zbatimi, Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i ndërtesës godinës ish-objekti “Hotel Mira Mare”, lagjia nr.13, Durrës, ka qenë në përputhje me kushtet teknike kombëtare dhe kuadrin rregullator ligjor për ndërtimin në RSH si dhe për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë shembjen e ndërtesës është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik në fushën e ndërtimit.

Nga Akt Ekspertimi Teknik në lidhje me objektin 5 kate, ish-“Hotel Mira Mare”, ka rezultuar ndër të tjera se:

- Studimi, Projektimi, Zbatimi dhe Kolaudimi i godinës “Hotel Mira Mare”, nuk është kryer sipas standardit, kushtit teknik kombëtar për ndërtimin në RSH në fuqi në kohën e kryerjes së ndërtimit.

-Objekti është legalizuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, në dosjen e të cilit ndodhet edhe akti i ekspertimit teknik mbi qëndrueshmërinë e objektit të ndërtuar. Nëse ky akt ekspertimi, i hartuar nga ekspert i licencuar, do të ishte hartuar mbi të dhëna shkresore, prova laboratorike të materialeve të përdorura, sondazheve, studimeve gjeologjiko-inxhinierike dhe inxhinierio-sizmologjik, akti i ekspertimit mbi qëndrueshmërinë e objektit do të ishte më i plotë dhe mund të evidentoheshin kushtet e zbatimit të KTP dhe KTZ gjatë ndërtimit të tij. Paraqitja reale e gjendjes së objektit në këtë akt ekspertimi të paraqitur në dosjen e legalizimit, do të shmangte procedurën e legalizimit, duke krijuar mundësinë që objekti të ishte shembur nga insitucionet kompetente pa shkaktuar viktima.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së ndërtimit të objektit “Hotel Mira Mare”, lagjia nr.13, Durrës, shtetasi Rruzhdhi Xheka në cilësinë e investitorit dhe ndërtuesit pa leje me veprimet dhe mosveprimet e tij ka konsumuar elementët e veprës penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, në dëm të dy viktimave Sotiraq Misha dhe Evjola Broshka. Shtetasi Rruzhdhi Xheka ka kryer ndërtimin e objektit pesë katësh, pa respektuar rregullat dhe normat ligjore në fushën e ndërtimit përsa i përket studimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit ndërtimor, gjë e cila ka sjellë si pasojë shembjen e objektit nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe vdekjen e dy shtetasve Sotiraq Misha dhe Evjola Broshka që gjendeshin në këtë objekt.

Nga ana e shtetasit Rruzhdhi Xheka pavarësisht se po ndërtonte një objekt ndërtimor pesë katësh me funksion social ekonomik “Hotel”, në kundërshtim me ligjin nuk ka pajtuar asnjë specialist të fushës së projektimit dhe ndërtimit me qëllim kryerjen e studimit gjeologjik, sizmik dhe më pas hartimin e projektit konstruktiv të objektit. Po kështu, edhe gjatë zbatimit të punimeve nuk është mbajtur asnjë lloj dokumentacioni për cilësinë e materialeve të ndërtimit, cilësinë e punimeve dhe mbi volumet e punimeve të kryera në këtë objekt (libër masash mbi punimet e kryera dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit të përdorur, situacionet e punimeve, akt kolaudimi apo ekspertimi teknik lidhur me qëndrueshmërinë sipas parashikimeve ligjore, etj).

Shtetasi Rruzhdhi Xheka me dashje direkte e ka kryer ndërtimin e objektit në mënyrë të kundraligjshme dhe pa lejen e organeve kompetente, duke besuar tek aftësitë e tij apo personave që kanë marrë pjesë në ndërtimin e këtij objekti se objekti mund të jetë i qëndrueshëm nga pikëpamja teknike, por pasojat e ardhura nga shembja e ndërtesës së ndërtuar nga vetë ai kanë ardhur nga pakujdesia, pasi ai nuk i ka parashikuar pasojat që mund të vinin, megjithëse sipas rrethanave në të cilat është kryer ndërtimi ai duhet ti parashikonte. Shtetasi Rruzhdhi Xheka, jo vetëm nuk i është përmbajtur legjislacionit në fushën e ndërtimit lidhur me KTP e KTZ, por edhe për legalizimin e objektit ka përdorur në mënyrë fiktive një kopje “Akt Ekspertizë mbi qëndrueshmërinë konstruktive të objektit”, e cila nuk i plotëson kushtet ligjore nga ana formale pasi paraqitet vetëm në formë fotokopje si dhe nuk plotëson kushtet e përmbajtjes së saj sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i mbajtur në emër të ing. Shyqyri Qemal Krymbi, që mban si datë vitin 2011.

Në kuadër të hetimeve të kryera, në Zyrën e Gjendjes Civile të Rajonit Nr.3 Durrës ka rezultuar se shtetasi Shyqyri Krymbi ka vdekur në datën 25.11.2013 dhe për këtë është marrë Çertifikatë vdekje e datës 10.12.2019. Ky dokument (Akt Ekspertiza) përbën dokumentin bazë lidhur me qëndrueshmërinë konstruktive të objekteve mbi katër kate, përpara se nga ana e zyrës së ALUIZNI-t të miratohet legalizimi i tij.

Nisur nga sa më sipër dhe mbështetur në faktet dhe provat e administruara në funksion të hetimeve të procedimit penal nr.2466 viti 2019 rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij shtetasi Rruzhdhi Xheka ka konsumuar elementët e veprës penale “Vrasja nga pakujdesia”,

parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal në dëm të viktimave Sotiraq Misha dhe Evjola Broshka.

**4.1.** Siç shikohet edhe më lart, nga ana jonë gjatë hetimeve paraprake është administruar pranë ASHK Durrës praktika e Aluizni-t që ka shërbyer për legalizimin e objektit, si dhe është sekuestruar dokumentacioni i praktikës së regjistrimit të pronës në ZVRPP Durrës. Nga verifikimi i dosjes së Aluizni-t dhe asaj të regjistrimit rezulton se u gjenden dokumentat e lartpërmendura: (të marra në cilësinë e provës materiale, tek të cilat vërehen disa parregullsi në to) e konkretisht: *Fotokopje- Akt Ekspertizë e objektit Godinë sociale-ekonomike pesë kate firmosur ing. Shyqyri Qemal Krymbi, Janar 2011, etj, tetë fletë.* Pra, në praktikën e dokumentave për legalizimin e objektit të mësipërm, rezulton se është pranuar një dokument i parregullt në formë, jo origjinal por fotokopje konkretisht një Akt Ekspertizë e objektit Godinë sociale-ekonomike, pesë kate, në emër të ing. Shyqyri Qemal Krymbi. Mirëpo në kuadër të hetimeve të kryera, në Zyrën e Gjendjes Civile të Rajonit Nr.3 Durrës ka rezultuar se shtetasi Shyqyri Krymbi ka vdekur në datën 25.11.2013 dhe për këtë është marrë Çertifikatë vdekje e datës 10.12.2019. Mbi bazen e këtij akti me date 20.12.2019 ka dale leja e legalizimit në emër të Rruzhdhi Xheka

Ky dokument përbën dokumentin bazë lidhur me qëndrueshmërinë konstruktive të objekteve mbi katër kate, përpara se nga ana e zyrës së ALUIZNI-t të miratohet legalizimi i tij.

*Konkretisht Neni 27 I ligjit nr.9482 date 03.04.2006, parashikon:*

*Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit*

*Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin*

*a) gen-planin e objektit në shkallën 1:500.*

*b) planimetrinë e çdo kati të objektit dhe sipërfaqet në m<sup>2</sup>, që do të legalizohen në shkallë 1:100;*

*c) certifikatën e përbërjes familjare;*

*ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;*

*d) vërtetimin ose certifikatën e pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë, nëse subjekti i disponon këto. I njëjti dokumentacion kërkohet dhe për ndërtimin me leje, apartamentin dhe njësinë e shërbimit, në rastin e shtesave pa leje të realizuara në këto ndërtime;*

*dh) deklaratën personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, si pasojë e faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit*

*e) akt-ekspertizë nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate;*

*ë) marrëveshjen noteriale për pjesët takuese, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, nëse ajo realizohet.*

Nga ana jonë me qëllim sqarimin e fakteve nëse, Projektimi, Zbatimi, Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i ndërtesës godinës ish-objekti “Hotel Mira Mare”, lagjia nr.13, Durrës, kanë qenë në përputhje me kushtet teknike kombëtare dhe kuadrin rregullator ligjor për ndërtimin në RSH si dhe për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë shembjen e ndërtesës është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik.

Nga Akt Ekspertimi Teknik përkatës në lidhje me objektin 5 kate, ish-“Hotel Mira Mare”, ka rezultuar ndër të tjera se:

Në konkluzion ekspertët përcaktojnë se:

*1-Mbështetur në argumentimin e bërë më lartë, grupi i ekspertëve konkludon se, referuar dokumentacionit të administruar, Studimi, Projektimi, Zbatimi dhe Kolaudimi i godinës*



*“Hotel Mira Mare”, nuk është kryer sipas standardit, kushtit teknik kombëtar për ndërtimin në RSH në fuqi në kohën e kryerjes së ndërtimit.*

*-Si konkluzion i gjithë argumenteve të mësipërme, grupi i ekspertëve konkludon se shembja e objektit “Hotel Mira Mare”, ndodhur në lagjen nr. 13, Durrës, ka si shkak mos respektimin masave teknike që parashikon KTP dhe KTZ, si dhe kuadrin ligjor që rregullon ndërtimet në Republikën e Shqipërisë.*

Nga aktet e mësipërme rezulton se shtetasi Arben Isaku, në cilësinë e drejtorit të ALUIZNI-t Durrës, duke miratuar legalizimin e objektit 5-kate të “Hotel Mira Mare” pa plotësuar më parë kushtet tekniko-ligjore ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin nr.9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Konkretisht ai ka pranuar në praktikën e legalizimit të objektit 5-katësh një “Akt Ekspertizë”, të parregullt dhe jo origjinale (fotokopje), që mbante si datë vitin 2011 (përpara tetë vitesh) dhe ishte hartuar në emër të një eksperti i cili kishte vdekur përpara më shumë se pesë vitesh se të miratohej leja e legalizimit.

Kualifikimi për dhënie leje legalizimi i një objekti të ndërtuar në mënyrë të paligjshme dhe pa një strukturë të qëndrueshme përsa i përket rezistencës ndaj lëkundjeve sizmike, ka sjellë shembjen e tij (objektit) dhe për pasojë vdekjen e shtetasve Sotiraq Misha dhe Evjola Broshka të cilët gjendeshin në këtë objekt.

I pandehuri Arben Isaku në cilësinë e Drejtorit të Aluizni-t Durrës nuk e ka trajtuar dhe shqyrtuar konform kërkesave ligjore dokumentacionin e paraqitur para tij, por në kundërshtim me detyrimin ligjor ka urdhëruar legalizimin e objektit duke u mbështetur në të dhëna të parregullta në formë dhe në përmbajtje.

Sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij i pandehuri Arben Isaku ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**4.2.** Po kështu, vlen të theksohet se nga provat e administruara në funksion të këtij procedimi penal dhe aktet e mësipërme, rezulton se shtetasi Aldo Dakoveli në cilësinë e Përgjegjësit të Zyrës së Aluizni-t Durrës, duke konfirmuar me anë të nënshkrimit të tij plotësimin për miratimin e legalizimit të objektit 5-kate të “Hotel Mira Mare”, pa u plotësuar më parë kushtet tekniko-ligjore ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin nr.9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Konkretisht ai ka pranuar në praktikën e legalizimit të objektit 5-katësh një “Akt Ekspertizë”, të parregullt dhe jo origjinale (fotokopje), që mbante si datë vitin 2011 (përpara tetë vitesh) dhe ishte hartuar në emër të një eksperti i cili kishte vdekur përpara më shumë se pesë vitesh se të miratohej leja e legalizimit.

Kualifikimi për dhënie leje legalizimi i një objekti të ndërtuar në mënyrë të paligjshme dhe pa një strukturë të qëndrueshme përsa i përket rezistencës ndaj lëkundjeve sizmike, ka sjellë shembjen e tij (objektit) dhe për pasojë vdekjen e shtetasit Sotiraq Misha dhe Evjola Broshka të cilët gjendeshin në këtë objekt.

I pandehuri Aldo Dakoveli në cilësinë e Përgjegjësit të Aluizni-t Durrës nuk e ka trajtuar dhe shqyrtuar konform kërkesave ligjore dokumentacionin e paraqitur para tij, por në kundërshtim me detyrimin ligjor ka urdhëruar legalizimin e objektit duke u mbështetur në të dhëna të parregullta në formë dhe në përmbajtje.

Sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij i pandehuri Aldo Dakoveli ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**5. Objekti i banimit 6-katësh, pallati nr.1032,** i ndodhur në rrugën “Shoqëria Bashkimi”, lagjia nr.6, Durrës, i cili është shembur në dy katet e para dhe qëndronte si bllok nga kati i

tretë (rrafsh me sipërfaqen e tokës) deri në katin e gjashtë, nga shembja e të cilit kanë humbur jetën shtetasit Nafije Rexhepi dhe Zhuljeta Gjana.

Nga hetimet e zhvilluara rezuloi se objekti gjashtë katësh ishte ndërtuar në vitet 1988-1989 sipas lejes së ndërtimit të vitit 1966 si godinë banimi 6 kate mbi tokë dhe 0 kate nën tokë, me sipërfaqe të gjurmës së ndërtimit 230 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe totale 1406 m<sup>2</sup>. Në katin e parë të këtij objekti funksionte një aktivitet ekonomik “Bar Barons”, i cili ishte përshtatur nga një apartament me sipërfaqe prej 83.47 m<sup>2</sup> si dhe një shtesë objekti pa leje me sipërfaqe 26 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasit Artur Terziu.

Nga ana jonë në kuadër të hetimeve paraprake është kryer këqyrja dhe rikëqyrja e vendit të ngjarjes si dhe marrja e mostrave të hekurit, betonit dhe materialeve të tjera të ndërtimit në objektin e banimit pallat 6-katesh, pallati nr.1032, në rrugën “Shoqëria Bashkimi” Durrës. Nga ana jonë është marrë vendim për ekspertimin dhe analizimin e cilësisë së këtyre materialeve të ndërtimit, ku për këtë qëllim janë hartuar Raport Analizat për Hekurin dhe Betonin nga kompania “ALTEA & GEOSTUDIO 2000”.

Më tej, me kërkesë të bërë nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është hartuar edhe Studim Inxhiniero-Sizmiologjik të Sheshit ku ndodhej pallati nr.1032, rruga “Shoqëria Bashkimi”, lagjia Nr.6, Durrës, shkurt 2020, nga kompania “ALTEA & GEOSTUDIO 2000, si dhe Studim mbi kushtet Gjeologo-Inxhinierike të Sheshit ku ndodhej Pallati.

Po kështu, me qëllim vlerësimin sa më integral të aspekteve strukturore, analizën e specifikimeve dhe detajeve teknike, etj., është marrë projekti konstruktiv i pallatit nr.1032 si dhe në Arkivën Qendrore Teknike e Ndërtimit (AQTN), është marrë projekti i plotë strukturor i pallatit TIP 82/2 bazuar në të cilin është hartuar edhe projekti i pallatit nr.1032, në lagjen nr.6, Durrës.

Në përfundim, nga ana jonë me qëllim sqarimin e fakteve nëse, Projektimi, Zbatimi, Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i ndërtesës godinës ish “pallati nr.1032, rruga “Shoqëria Bashkimi”, lagjia nr.6, Durrës, ka qenë në përputhje me kushtet teknike kombëtare dhe kuadrin rregullator ligjor për ndërtimin në Republikën e Shqipërisë si dhe për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë shembjen e ndërtesës është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik në fushën e ndërtimit.

Nga Akt Ekspertimi Teknik në lidhje me objektin ish-pallati nr.1032, rruga “Shoqëria Bashkimi”, lagjia nr. 6, Durrës, ka rezultuar ndër të tjera se:

*Nga mënyra e organizimit të sektorit të ndërtimit në atë kohë, para viteve ‘90, mund të nënkuptohet që gjithë dokumentacioni është plotësuar dhe gjithë kërkesat ligjore janë respektuar, por gjithsesi vlen të theksohet që cilësia tejmase e dobët e betonit në vepër tregon që disa nga proceset edhe mund të jenë anashkaluar ose mos respektuar me rigorozitet.*

*Sa i përket zbatimit të KTP, grupi i ekspertëve sqaron që bazuar në projektin konstruktiv të Pallatit nr. 1032 (i përshtatur sipas Projektit TIP 82/2), që administrohet në dosjen hetimore, konstatohet që specifikimet teknike dhe masat konstruktive të parashikuara janë në përputhje me Kushtet Teknike të Projektimit në fuqi.*

*Lidhur me shkaktuesit që ka sjellë shembjen e objektit të mesiperm ekspertet arrijnë në konkluzionin se referuar rezultateve të analizës strukturore rezulton që shkaqet kryesore të shembjes së “Pallatit 1032, Lagja nr.6, Rr. Bashkimi, Durrës” të kenë qënë: Dëmtimet paraprake të tërmetit i 21 Shtator 2019 me Magnitudë 5.6 si dhe cilësia e dobët e betonit të përdorur për ndërtim, marka (rezistenca) e të cilit rezulton 50% më e vogël se ajo e specifikuar në projekt.*

Mbeshtetur në konkluzionet e mesiperme shkaku i shembjes së objektit Pallati nr. 1032, Lagja nr. 6, Rr. Bashkimi, Durrës, ka qenë cilësia e dobët e materialeve të ndërtimit, e konkretisht betonit i cili ka rezultuar 50% më e vogël se ajo e specifikuar në projekt. Në këto kushte nuk provohet se

veprimet per kryerjen e punimeve pa leje nga ana e shtetasit Artur Terziu, te kene sjelle pasojen e ardhur.

Sidoqofte vlen te theksohet se gjate hetimeve te kryera per kete procedim nga ana e policisë gjyqësore janë administruar pranë ASHK Durrës praktikat e Aluizni-t që kanë shërbyer për regjistrimin e apartamentit dhe legalizimin e shtesës anësore 26m<sup>2</sup> të këtij lokali në emër të shtetasit Artur dhe Anisa Terziu.

Konkretisht në lidhje me apartamentin në emër të Artur dhe Anisa Terziu në ZVRPP Durrës, janë sekuestruar dokumentat si vijon:

- Referenca me nr.00034367, ZK.8513, me numër pasurie 3/66+1-3, me emër Fatos Lazimi, bashkëlidhur kërkesa e datës 25.04.2019, së bashku mandat pagesë dhe kontratë shitblerje me nr.1122Rep dhe nr.317/1Kol, datë 17.04.2019, pala shitëse Edmond Zhupa pala blerëse Erjon Lazimi.
- Çertifikatë pronësie në emër të Edmond Zhupaj, harta treguese, kartela e pasurisë.
- Kontratë shitjeje nga Enti i Banesave me nr.19Rep dhe nr.16Kol, datë 01.01.2005, pala shitëse Enti i Banesave dhe pala blerëse Edmond Zhupa, bashkëlidhur planimetria e apartamentit.
- Deklaratë noteriale për dhënie pëlqimi me bankën me nr.1091Rep dhe nr.304/1 Kol, me palë Banka OTP Albania dhe Edmond Zhupa.
- Prokurë e posaçme me nr.935Rep dhe 432/2Kol, ku Edmond dhe Nazmi Zhupaj kanë emëruar Bujar Imaj të merret me shitjen e apartamentit dhe dokumentacioni bashkëlidhur që e vërteton.
- Referenca me nr.00023719, ZK.8513. me numër pasurie 3/66+1-5, me emër Artur Terziu, Anisa Terziu, bashkëlidhur kërkesa e datës 04.07.2014, së bashku mandat pagesë dhe kontratë shitblerje me nr.2183Rep dhe nr.791/1Kol, datë 25.06.2014, pala shitëse Naim Bregu pala blerëse Artur Terziu.
- Çertifikatë pronësie në emër të Naim Bregu e të tjerë, harta treguese, kartela e pasurisë.
- Prokurë e posaçme me nr.3079, datë 18.06.2014 me dy gjuhë shqip dhe greqisht, ku Aleksandra Bregu jep pëlqimin për shitjen e apartamentit Armand Bregut.
- Referenca me nr.0012, ZK.8513, me numër pasurie 3/66+1-2, me emër Kastriot Zhupaj dhe Besije Zhupaj, bashkëlidhur kërkesa e datës 17.11.1996, së bashku me mandat pagesën.
- Autorizim i datës 26.08.1996, mandat arkëtimi me nr.06 datë 26.11.1996, mandat arkëtimi me nr.266 i datës 25.11.1996.
- Kontratë për privatizimin e banesës e datës 26.11.1996, bashkëlidhur formulari, planimetria e apartamentit, njoftim për regjistrimin fillestar, planimetria, çertifikata familjare.
- Kontratë shitjeje nga Enti i Banesave me nr.2816Rep dhe nr.844Kol, datë 26.05.1997.
- Referenca me nr.0011, ZK.8513, me nr.pasurie 3/66+1-1, me emër Fatmir Gjana dhe Zhuljeta Gjana, bashkëlidhur kërkesa e datës 03.09.1993, së bashku me mandat arkëtimi.
- Autorizim i datës 13.10.1993.
- Formulari nr.2 dhe formulari nr.3, autorizim i datës 05.07.1990.
- Planimetria e apartamentit, njoftim për regjistrimin fillestar, çertifikata familjare.
- Kontratë shitjeje nga Enti i Banesave me nr.9732Rep dhe nr.9732Kol, datë 19.02.1993.

Nga verifikimi i dosjes së Aluizni-t dhe ZVRPP-së Durrës, në lidhje me shtesën e ndërtimit rezulton se u gjenden dokumentet e renditura si më poshtë vijon:

- Deklaratë personale datë 28.04.2016 ku shtetasi Artur Terziu posedon objekt me funksion aktivitet me adresë Durrës, (*Deklarata është pa nënshkrimin e deklaruesit*).

- Deklaratë për përfshirje në proces legalizimi nr.1643 (pa datë) ku shtetasi Artur Terziu deklaroi se ndërtimi është ngritur në vitin 2009, me adresë L.6 Rr Bashkimi, nënshkruar nga Artur Terziu.
- Çertifikata për vërtetimin e pronësisë në emër të shtetasit Artur dhe Anisa Terziu për Llojin e pasurisë Apartament me sipërfaqe 83.47m<sup>2</sup>.
- Procesverbal i verifikimit në terren që mban datë 28.04.2016 (e njëjta datë që është bërë edhe deklarata personale si dhe ky procesverbal nuk ka emrin e asnjërit nga specialistët që kanë bërë matjet në terren por vetëm nënshkrimin në vendin përkatës që nënshkruhet nga përgjegjësi i hartografisë (I. Keçi)
- Skicat fushore (planimetrike e katit përdhe dhe Gen plan) me pronar Artur dhe Anisa Terziu L.6 dhe funksioni social ekonomik, (pa datë) dhe nënshkruar nga A.Malko dhe H.Huqi.
- Planimetria e katit përdhe dixhitale “shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues 6 kat” e cila mban datën 28.04.2016 (në të njëjtën ditë që është bërë deklarata personale dhe procesverbali i verifikimit në terren, në këtë kanë nënshkruar punoi Rudina Zela; përditësoi është pa nënshkrim; përgjegjësi i sektorit GIS Ilirjan Keçi dhe drejtorit Flamur Gjuzi).
- Gen plan, për sip ndërtimi 26m<sup>2</sup>, (pa datë, dhe nuk tregoj se kujt i përket sipërfaqja e parcelës ndërtimore, sipërfaqe shtet apo sip e të tretëve ) nënshkruar nga përgjegjësi i Hartografisë Ilirjan Keçi, përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë Elvis Pengili dhe drejtori Flamur Gjuzi.
- Vendim për kualifikimin e ndërtimit informal nr.14422 datë 02.05.2016, (4 ditë pas matjeve në terren, i nënshkruar nga S.Bello datë 17.05.2016 dhe drejtori Flamur Gjuzi.
- Akt ekspertimi teknik datë 09.05.2016-12.05.2016 i mbajtur nga ana e ekspertit ing Defrim Celami, formal pa nënshkrimin e investitorëve Artur Bajram Terziu dhe Anisa Fatos Terziu. Bashkëngjitur këtij akti janë dhe planimetria e katit përdhe, si dhe fotografi të pallatit ku në katin e parë ndodhet lokali “Barons”.
- Shkresë nr.8283 datë 17.05.2016, Aluizni drejtuar Bashkisë Durrës zyrës së urbanistikës ku i kërkon nëse në zonën kadastrale me nr.8513 ku zhvillohet objekt pa leje i vetëdeklaruar për legalizim nga subjektet Artur dhe Anisa Terziu cënon apo jo trungun kryesor të infrastrukturës inxhinierike si dhe rrugën, trotuare në inventarin e Bashkisë Durrës, nënshkruar nga drejtori Flamur Gjuzi.
- Leja e legalizimit nr.613 datë 17.05.2016, për objektin shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues 6 kat i jepet Artur dhe Anisa Terziu në lagjen 6 të Bashkisë Durrës, sip 26m<sup>2</sup>, nënshkruar nga përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit P/S.Bello dhe drejtori Flamur Gjuzi. Kjo leje legalizimi ka të njëjtën datë 17.05.2016 me shkresën që Aluizni i kërkon zyrës së urbanistikës informacion, pra ka bërë legalizimin e shtesës pa marrë përgjigje.
- Shkresë nr.29660 datë 24.12.2016 ku Aluizni i dërgon Bashkisë Durrës njoftim mbi pajisjen me leje legalizimi të subjektit Artur dhe Anisa Terziu.
- Shkresë nr.29661 datë 24.12.2016 ku Aluizni i dërgon ZVRPP Durrës dosjen për regjistrim fillestar.

Nga verifikimi i dosjes së ZVRPP për shtesën e kryer nga shtetasi Artur Terziu rezultoi të ketë këto dokumenta si më poshtë:

- Aplikim dhe mandate arkëtimi.
- Planimetria e katit përdhe dixhitale “shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues 6 kat” e cila mban datën 28.04.2016 (në të cilën është nënshkruar punoi Rudina Zela; përditësoi është nënshkrim A.Qetka (i cili nuk e ka emrin të skicat fushore).
- Liçencë nr.6727 e shoqërisë Gjeodetika 2010 SH.P.K, me shkrim dore ka shënimin “kjo licencë është e vlefshme vetëm për planrivelime z.Artur Bajram Terziu etj”.

- Shkresë nr.13/1 datë 06.01.2017 e Bashkisë Durrës drejtuar ZVRPP Durrës që e vërteton se subjekti Artur dhe Anisa Terziu prot nr.13 datë 05.01.2016 ka paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Durrës për objektin e legalizuar.

Nga hetimet e kryera rezulton se nga ana e shtetasit Artur Terziu është kryer në kundërshtim me ligjin ndryshimi i destinacionit të pasurisë nga pasuri e llojit banesë (apartament) duke u përshtatur për qëllime tregtare në “Bar Kafe” të emërtuar “Barons” pa lejen e organeve kompetente. Në vazhdimësi ky shtetas ka kryer pa lejen e organeve kompetente një shtesë ndërtimi me sipërfaqe 26m<sup>2</sup> në të tre anët e apartamentit të përshtatur në lokal për shërbime Bar-Kafe.

Nga dokumentacioni që ndodhet në dosjen e ALUIZNI-T rezulton se deklaratën për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe ose shtesës ose ndërtimit me leje shtetasi Artur Bajram Terziu ka deklaruar, se ndërtimi është ngritur në vitin 2009, ndërkohë që vetë shtetasi Artur Terziu apartamentin e ka blerë me datë 25.06.2014. Nga ana e tij shtetasi Artur Terziu, ka bërë një deklaram për kryerje punimesh dhe nga ana e Bashkisë Durrës është dhënë autorizimi nr.4928 prot datë 18.08.2014 që Bashkia Durrës e autorizon shtetasin Artur Terziu për të bërë punime për mirëmbajtjen e apartamentit brenda afatit 3 mujor si dhe njëkohësisht me shkresën nr.4929 datë 18.08.2014 i drejtohet Kryeinspektorit Artur Çela në Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Durrës që të shikohet me rigorozitet zbatimin i afateve kohore të punimeve që po bëhet nga ana e shtetasve Artur dhe Anisa Terziu dhe mosdalja jashtë përcaktimeve të ligjit nr.110/2013 pika 2 e nenit 70/33 për punime për mirëmbajtje. Ky objekt me datë 28.04.2016 është deklaruar për legalizim në ALUIZNI Durrës, nga ana e shtetasit Artur Terziu dhe me pas janë kryer procedurat e legalizimit ku me datë 17.05.2016 I ka dalë edhe Leja e legalizimit nr.613.

Siç shikohet edhe më lart, shtetasi Artur Terziu, deri në vitin 2016 ka kryer në mënyrë të kundraligjshme ndërtimin pa leje të shtesës prej 26m<sup>2</sup> si dhe përshtatjen e apartamentit të banimit në lokal për shërbime “Bar Kafe”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, nga ana e shtetasit Artur Terziu në kërkesën për përfshirje në legalizim të shtesës së ndërtimit datë 28.04.2016 është dërguar si pjesë e dokumentacionit tekniko-ligjor edhe një dokument i falsifikuar i parregullt në përmbajtje dhe në formë, i cili titullohet “Akt ekspertimi” datë 09.05.2016-12.05.2016 me nënshkrimin në emër të ing. Defrim Celami, por pa nënshkrimin e investitorëve Artur Bajram Terziu dhe Anisa Fatos Terziu. Gjate hetimit rezultoi se edhe ky akt ekspertimi rezultoi nuk është mbajtur nga ana e inxhinierit Defrim Celami dhe nga përmbajtja e tij ky akt nuk flet për qëndrueshmërinë e objektit por jep vetëm karakteristika të pjesëshme të punimeve të kryera. Sipas akt ekspertimit teknik grafik nr. A1 datë 20.01.2020 ka rezultuar se nënshkrimi Defrim Celami në “Akt ekspertimi” datë 09.05.2016-12.05.2016 nuk është nënshkruar nga ana e shtetasit Defrim Celami.

Sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij shtetasi Artur Terziu ka konsumuar elementët e veprave penale “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 199/a/3 dhe neni 186/1 i Kodit Penal.

**5.1.** Gjate hetimeve paraprake është marrë nën hetim edhe shtetasi Defrim Celami për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se dyshohet se ky shtetas në kundërshtim me ligjin kishte hartuar “Akt ekspertimi” datë 09.05.2016-12.05.2016, pa kryer me pare verifikimet perkatëse. Me tej në lidhje me faktin nëse ky Akt Ekspertimi është nënshkruar nga shtetasi Defrim Celami në cilësinë e ekspertit, është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit përkatës dhe nga Akt ekspertimi kriminalistik (Ekspertim tekniko-grafik dokumenti) nr.A1/2020 datë 20.01.2020, i ekspertit kriminalistik rezulton si konkluzion: Nënshkrimi i plotë (emër-mbiemër dhe firmë) në emër të Defrim Celami i ndodhur nën rekuizitën “EKSPERTI”, në dokumentin objekt “Akt Ekspertimi Teknik” në emër të Defrim Celami për “Objektin Shtesë Anësore një kat në objektin

ekzistues 6 kate” - Lagjia nr.6 Bashkia Durrës, nuk është nënshkrim origjinal i Defrim Celami, *krahasuar me modelet e lira dhe eksperimentale të vëna në dispozicion*. Duke u nisur nga ky konkluzion, rezulton se nuk provohet që shtetasi Defrim Celami të ketë hartuar dhe nënshkruar këtë akt dhe si i tillë nuk provohet se ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Duke u nisur nga sa më sipër si dhe bazuar në kërkesat e nenit 328 pika 1 gërma “dh” dhe nenin 329/a pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, hetimet në ngarkim të tij duhet të pushohen.

**5.2.** Siç shikohet edhe më lart, nga aktet e administruara nga ana jonë në interes të hetimit ka rezultuar ndër të tjera së nga ana e shtetasit Artur Terziu është kryer në kundërshtim me ligjin ndryshimi i destinacionit të pasurisë nga pasuri e llojit banesë (apartament) duke u përshtatur për qëllime tregtare në “Bar Kafe” të emërtuar “Barons” pa lejen e organeve kompetente. Në vazhdimësi ky shtetas ka kryer pa lejen e organeve kompetente një shtesë ndërtimi me sipërfaqe 26 m<sup>2</sup> në të tre anët e apartamentit të përshtatur në lokal për shërbime Bar-Kafe.

Nga dokumentacioni që ndodhet në dosjen e ALUIZNI-T rezulton se në deklaratën për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe ose shtesës ose ndërtimit me leje shtetasi Artur Bajram Tereziu, është deklaruar, se ndërtimi është ngritur në vitin 2009, ndërkohë që vetë Artur Terziu apartamentin e ka blerë me datë 25.06.2014. Nga ana e tij shtetasi Artur Terziu, ka bërë një deklaram për kryerje punimesh dhe nga ana e Bashkisë Durrës është dhënë autorizimi nr.4928prot datë 18.08.2014 që Bashkia Durrës e autorizon shtetasin Artur Terziu për të bërë punime për mirëmbajtjen e apartamentit brenda afatit 3 mujor si dhe njëkohësisht me shkresën nr.4929 datë 18.08.2014 i drejtohet Kryeinspektorit Artur Çela në Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Durrës që të shikohet me rigorozitet zbatimin i afateve kohore të punimeve që po bëhen nga ana e shtetasve Artur dhe Anisa Terziu dhe mosdalja jashtë përcaktimeve të ligjit nr.110/2013 pika 2 e nenit 70/33 për punime për mirëmbajtje. Pra shtetasi Artur Terziu, nga viti 2014 deri në muajin Prill të vitit 2016 (kur ka aplikuar për legalizim) ka kryer në mënyrë të kundraligjshme ndërtimin pa leje të shtesës prej 26m<sup>2</sup> si dhe përshtatjen e apartamentit të banimit në lokal për shërbime Bar Kafe, në kundërshtim me kërkesat e ligjit.

Sic shihet edhe më lart, shtetasi Artur Çela, në cilësinë e Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Durrës i ngarkuar për inspektimin e territorit në të cilin është kryer ndërtimi pa leje, nuk ka ndjekur konstatuar dhe ndaluar punimet për ndërtimin e paligjshëm të kryera nga shtetasi Artur Terziu, i cili më parë kishte marrë një autorizim të datës 18.08.2014, për të kryer punime mirëmbajtje të apartamentit, sipas ligjit nr.110/2013 pika 2 nenit 70/33 dhe ishte njoftuar me shkresën nr.4929 datë 18.08.2014, të Bashkisë Durrës. Mirëpo shtetasi Artur Çela në kundërshtim me kërkesat e neneve 4, 5 e vijues të ligjit nr.9780 datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, me mosveprime ka lejuar që shtetasi Artur Terziu, të ndërtojë pa leje një objekt shtesë prej 26m<sup>2</sup> si dhe përshtatjen e apartamentit të banimit në lokal për shërbime Bar Kafe.

Sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij shtetasi Artur Çela ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**5.3.** Nga ana tjetër rezultoi se shtetasi Klajdi Lame, në cilësinë e Inspektorit të Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Durrës i ngarkuar për inspektimin e territorit në të cilin është kryer ndërtimi pa leje, nuk ka ndjekur konstatuar dhe ndaluar punimet për ndërtimin e paligjshëm të kryera nga shtetasi Artur Terziu, i cili më parë kishte marrë një autorizim të datës 18.08.2014, për të kryer punime mirëmbajtje të apartamentit, sipas ligjit nr.110/2013 pika 2 e nenit 70/33 dhe ishte njoftuar me shkresën nr.4929 datë 18.08.2014, të Bashkisë Durrës. Mirëpo shtetasi Klajdi Lame në kundërshtim me kërkesat e neneve 4, 5 e vijues të ligjit nr.9780 datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”, i ndryshuar, me mosveprime ka lejuar që shtetasi Artur Terziu, të ndërtojë

pa leje një objekt shtesë prej 26m<sup>2</sup> si dhe përshtatjen e apartamentit të banimit në lokal për shërbime Bar Kafe.

Sa më sipër rezulton se mosveprimet e tij shtetasi Klajdi Lame ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**5.4.** Nga hetimet e kryera në lidhje me këtë objekt e konkretisht në dosjen e ALUIZNI-t, Durrës, ka rezultuar e provuar ndër të tjera se:

- Deklaratë personale datë 28.04.2016 *është pa nënshkrimin e deklaruesit.*
- Deklaratë për përfshirje në proces legalizimi nr.1643 *(pa datë).*
- Procesverbal i verifikimit në terren që mban datën 28.04.2016 *(e njejtja datë që është bërë edhe deklarata personale si dhe ky procesverbal nuk ka emrin e asnjërit nga specialistët që kanë bërë matjet në terren por vetëm nënshkrimin në vendin përkatës që nënshkruhet nga përgjegjësi i hartografisë (Ilirjan Keçi).*
- Skicat fushore (panimetria e katit përdhe dhe Gen plan, *pa datë*, dhe nënshkruar nga A. Malko dhe H. Huqi.
- Planimetria dixhitale e katit përdhe “shtesë anësore 1 kat në objektin ekzistues 6 kat” e cila mban datën 28.04.2016 mban të njejtën datë që është bërë deklarata personale dhe procesverbali i verifikimit në terren. Në këtë planimetri ka emrin Albrend Qetka i cili nuk e ka emrin tek skicat fushore.
- Gen plan, për sip ndërtimi 26m<sup>2</sup>, *(pa datë dhe nuk tregon se kujt i përket sipërfaqja e parcelës ndërtimore).*
- Vendim për kualifikimin e ndërtimit informal nr.14422 datë 02.05.2016, (4 ditë pas matjeve në terren).
- Akt ekspertimi teknik datë 09.05.2016-12.05.2016 i mbajtur nga ana e ekspertit ing Defrim Celami, formal pa nënshkrimin e investitorëve dhe nuk flet për qëndrueshmërinë e objektit.
- Shkresë nr.8283 datë 17.05.2016, Aluizni drejtuar Bashkisë Durrës Zyrës së Urbanistikës ku i kërkon nëse në zonën kadastrale nr.8513 ku zhvillohet objekti pa leje i vetëdeklaruar për legalizim nga subjektet Artur dhe Anisa Terziu cënon apo jo trungun kryesor të infrastrukturës inxhinierike si dhe rrugën, trotuare në inventarin e Bashkisë Durrës, nënshkruar nga drejtori Flamur Gjuzi. Për këtë shkresë nuk ka përgjigje.
- Leja e legalizimit nr.613 datë 17.05.2016, e cila ka të njejtën datë 17.05.2016 me shkresën që Aluizni i kërkon informacion dhe nuk merr përgjigje nga ana e Zyrës së Urbanistikës Bashkia Durrës.

Lidhur me sa më lart shtetasi Helio Huqi, specialist i matjeve në terren, në lidhje me rastin e shtesës së bërë nga shtetasi Artur Terziu, sqaron se nuk e ka patur ai këtë praktikë dhe nuk është nënshkrimi i tij në skicat fushore dhe nuk ka nënshkrim në procesverbalin e verifikimit në terren. Gjithashtu, sqaron se pasi printohet planimetria dixhitale është e detyrueshme që të nënshkruhet nga njëri nga dy specialistët që kanë bërë matjet në terren në vendin përkatës “përditësoi” *(ku në praktikën e Aluizni-t është bosh, ndërsa në praktikën e dërguar nga Aluizni në ZVRPP është emri A.Qetka).*

Ndërkohë i pandehuri Artenis Malko, specialist i matjeve në terren, sqaron se ka qenë ai që ka bërë matjet në terren tek objekti në proces legalizimi bërë nga Artur Terziu dhe deklaroi se procesverbali i verifikimit në terren mund të jetë ndryshuar pasi nuk ka nënshkrimin e asnjërit nga dy specialistët që është bërë matja dhe nuk ka shkruar fare në këtë procesverbal. Por duke parë skicat fushore sqaron se ka qenë së bashku me kolegun Helio Huqi, por nuk është shkrimi i tij tek të dhënat. Gjithashtu, sqaron se pasi printohet planimetria dixhitale është e detyrueshme që të nënshkruhet nga njëri nga dy specialistët që kanë bërë matjet në terren në vendin përkatës “përditësoi”.

Nga ana tjetër i pandehuri Albrend Qetka, specialist i matjeve në terren, ka sqaruar se në kohën që është bërë legalizimi i shtesës së mësipërme ka qenë specialist matjeje në terren Dega e Aluizni-t Shijak dhe sqaron se pasi printohet planimetria dixhitale është e detyrueshme që të nënshkruhet nga njëri nga dy specialistët që kanë bërë matjet në terren në vendin përkatës “përditësoi”. Duke parë praktikën e ZRVPP, pikërisht planimetrinë dixhitale të katit përdhe të shtesës 26m<sup>2</sup>, ai sqaron se ka qenë ai për të bërë matjet në atë vend përderisa është i bindur se është nënshkruar nga vetë ai në këtë planimetri, por nuk mban mend se me kë ka qenë për të bërë matjet tek ky objekt.

Më tej shtetasi Ilirjan Keçi, me detyrë përgjegjës i sektorit të hartografisë sqaron procedurën e punës që nga momenti që del dosja fillestare nga arkiva (*deklarata personale e shtetasit Artur Terziu është bërë me datë 28.04.2016 në të njejten datë që janë bërë dhe aktet e tjera, skicat fushore, procesverbali i verifikimit në terren dhe planimetria dixhitale*) konkretisht se specialistët e terrenit pasi bëjnë matjet e objektit mbajnë skicat fushore duke vendosur funksionin emrin e personit, i nënshkruan ato dhe i dorëzon me procesverbal për verifikimin në terren tek zyra e hartografisë. Procesverbali nënshkruhet detyrimisht nga ana e tij dhe specialistëve që kanë bërë matjen në terren dhe më pas kalon për dixhitalizimin e të dhënave ku planimetria printohet në tre fletë (një për në dosjen e legalizimit, një për në praktikën që i shkon ZVRPP dhe një i jepet qytetarit) por sqaron se pasi printohet planimetria dixhitale është e detyrueshme që të nënshkruhet nga njëri nga dy specialistët që kanë bërë matjet në terren në vendin përkatës “përditësoi”, pasi ai e shikon nëse përputhen të dhënat e planimetrisë që ka bërë ai me planimetrinë dixhitale. Në lidhje me mënyrën se si ai i kishte pranuar procesverbalin pa nënshkrimin e specialistëve të terrenit, ai pretendon se mund të jetë bërë ndonjë gabim dhe zëvendësuar procesverbali me një të ri dhe nuk e kujton si rast, ndërsa në lidhje me mosnënshkrimin në planimetrinë dixhitale te vendi përditësoi, ai sqaron se mund të jetë harruar nga ana e tyre por mund të jenë nënshkruar dy planimetritë e tjera (ku faktikisht ajo që i është dërguar ZVRPP-së është nënshkruar nga A.Qetka që nuk ka përpiluar skicat fushore).

Shtetasi Gerti Aleksi, ish-përgjegjës për sektorin e legalizimeve i pyetur në lidhje me objektin konkret sqaron se nuk ka dijeni pasi praktika e dokumentacionit të legalizimit të kësaj shtese është nënshkruar nga shtetasi Skerdi Bello, i cili është punonjës në ALUIZNI dhe nuk ka dijeni se çfarë urdhër pune ka patur nga titullari.

Duke u nisur sa më sipër rezulton se nga ana e Drejtorit të Zyrës së Aluizni-t Durrës shtetasit Flamur Gjuzi nuk janë respektuar kërkesat e ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për procedurat për realizimin e legalizimit të ndërtimeve informale”, lidhur me vlerësimin dhe lëshimin e lejes për legalizimin e shtesës anësore dhe më konkretisht: është pranuar një dokument i parregullt në përmbajtje dhe në formë, i cili titullohet “Akt ekspertimi” datë 09.05.2016-12.05.2016 i mbajtur nga ana e ekspertit ing Defrim Celami, por pa nënshkrimin e investitorëve Artur Bajram Terziu dhe Anisa Fatos Terziu. Pavarësisht se ky akt ekspertimi rezultoi gjatë hetimit se ishte i falsifikuar, sidoqoftë në përmbajtjen e tij ky akt nuk flet për qëndrueshmërinë e objektit, por jep vetëm karakteristika të pjesëshme të punimeve të kryera (siç parashikon neni 37/a e vijues i Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006). Po kështu nuk ka administruar përgjigjen e Bashkisë Durrës, të cilës me datë 17.05.2016, vetë Zyra e Aluizni-t Durrës i kishte kërkuar të konfirmonte faktin nëse në zonën kadastrale nr.8513 ku zhvillohet objekt pa leje i vetëdeklaruar për legalizim nga subjektet Artur dhe Anisa Terziu cënon apo jo trungun kryesor të infrastrukturës inxhinierike si dhe rrugën, trotuare në inventarin e Bashkisë Durrës, por shtesa u legalizua menjëherë, duke shkelur kështu kërkesat e parashikuara në nenin 2 dhe 4 te Kodit Rrugor dhe VKM nr.153 datë 07.04.2000.

Më tej nga verifikimi i dosjes së legalizimit të shtesës rezultoi ndër të tjera se edhe dokumentacioni që përmbante kjo dosje ishte i parregullt, e konkretisht: Kërkesa për pajisje me leje legalizimi ishte pa datë; procesverbali i verifikimit në terren pa firmat e specialisteve, skicat fushore pa datë, gen plani pa datë dhe nuk tregon pronësinë e tokës, etj, dhe pavaresisht nga kjo pas 19 ditësh nga momenti i hartimit të dokumentit të parë, ka miratuar lejen e legalizimit. Po kështu, rezulton se aplikimi për leje legalizimi është pranuar tej afatit



ligjor të përcaktuar në ligjin nr. nr.9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” neni 7, 8/c i cili përcakton se: c) në përfundim të afatit të vetëdeklarimit subjektivit i humb e drejta e legalizimit.

Shtetasi Flamur Gjuzi në cilësinë e Drejtorit të Zyrës së Aluizni-t Durrës nuk e ka trajtuar dhe shqyrtuar konform kërkesave ligjore dokumentacionin e paraqitur para tij, por në kundërshtim me detyrimin ligjor ka urdhëruar legalizimin e objektit duke u mbështetur në të dhëna të parregullta në formë dhe në përmbajtje, e kështu me veprimet dhe mosveprimet e tij ai ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**5.5.** Nga sa më sipër rezulton se i pandehuri Skerdi Bello punonjës në sektorin e legalizimeve pranë ALUIZNI Durrës, ka nënshkruar në vend të përgjegjësit Gerti Aleksi, në Vendimin e Kualifikimit datë 02.05.2016 dhe në lejen e legalizimit nr.613 datë 17.05.2016 po në vend të shtetasit Gerti Aleksi (pa delegim firme), ndërkohë që nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr.9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 36, e vijues. I pandehuri Skerdi Bello në cilësinë e specialistit nuk e ka trajtuar dhe shqyrtuar konform kërkesave ligjore dokumentacionin e paraqitur para tij, por në kundërshtim me detyrimin ligjor ka nënshkruar në vend të përgjegjësit duke urdhëruar legalizimin e objektit i mbështetur në të dhëna të parregullta në formë dhe në përmbajtje.

Sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij i pandehuri Skerdi Bello ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**5.6.** Nga sa më sipër rezulton se i pandehuri Artenis Malko punonjës në sektorin e legalizimeve pranë AUIZNI Durrës, ka hartuar skicat fushore, duke mos paraqitur të dhëna reale të objektit dhe konkretisht ato që kanë të bëjnë me distancën nga kufiri i rrugës si një nga kërkesat kryesore të ligjit nr.9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.280 datë 01.04.2015. I pandehuri Artenis Malko në cilësinë e specialistit nuk e ka trajtuar dhe shqyrtuar konform kërkesave ligjore dokumentacionin e paraqitur para tij, por në kundërshtim me detyrimin ligjor ka hartuar një pjesë të dokumenteve pa respektuar kërkesat e ligjit nr.9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.280 datë 01.04.2015.

Sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij i pandehuri Artenis Malko ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**5.7.** Nga sa më sipër rezulton se i pandehuri Albrend Qetka punonjës në sektorin e legalizimeve pranë AUIZNI Shijak, ka hartuar skicat fushore, duke mos paraqitur të dhëna reale dhe duke mos qenë i planizuar në Durrës por në Shijak, këto dokumenta i ka paraqitur më vonë dhe vetëm për të plotësuar praktikën e dokumentave pranë ZVRPP Durrës, në kundërshtim me ligjin nr.9482 datë 03.04.2006 i ndryshuar “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.280 datë 01.04.2015.

Sa më sipër rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e tij i pandehuri Albrend Qetka ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**6. Objekti pesë katësh “Hoteli Nr.4”, “Shtëpia e Pushimit të Ministrisë së Brendshme”, lagjia nr.13, plepa, Durrës, në zonën kadastrale 8518, nga shembja e të cilit ka humbur jetën**

shtetasi Bajram Hajdarmetaj, me detyrë pedagog në Akademinë e Rendit, i cili ishte akomoduar atë natë në këtë objekt.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore si:

- Këqyrja e vendit të ngjarjes së bashku me tabelat fotografike përkatëse.
- Marrja e mostrave të hekurit dhe betonit në rrënojat e këtij objekti.
- Analizat laboratorike të cilësisë së hekurit dhe betonit.
- Informacion nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit lidhur me lëkundjet e tërmetit të datës 26.11.2019.
- Studimi Sizmiologjik.
- Studimi Gjeologjik i sheshit të ndërtimit.
- Dokumentacioni tekniko-ligjor i objektit.
- Akti i ekspertimit mjeko ligjor i të ndjerit Bajram Hajdarmetaj datë 02.12.2019.
- Si dhe një numër i madh veprimesh të tjera hetimore si deklarime të personave që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale, etj.

Më tej në Zyrën e Arkives së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës janë marrë me procesverbalin e datës 09.12.2019, dokumentat si më poshtë:

- Dokumenti me nr.reference 0042, ZK 8518 me numër pasurie 53/1, vol.7, faqe 145 me emrin Shtëpia e Pushimit Ministria e Brendshme, bashkëlidhur me fletë inventari të datës 31.01.2017, bashkëlidhur me dy mandate pagese, aplikim kërkesë datë 11.02.2005.
- Kërkesë për hipotekim me nr.05, prot datë 10.01.2017 drejtuar ZRVPP Durrës, bashkëlidhur kërkesë për hipotekim me datë 10.02.2005. Kopje e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.250 datë 24.04.2003.
- Vendim me nr.316 datë 24.04.2003, shkresë e Zyrës Qendrore të RPP nr.498/1 datë 23.06.2003. Shkresë për hipotekim nr.05prot datë 10.02.2005. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.250 datë 24.04.2003.
- Vendimi nr.316 datë 24.04.2003, shkresë e Zyrës Qendrore të RPP nr.489/1 datë 13.06.2003 kopje. Shkresë e Ministrisë së Rendit Publik nr.349prot datë 02.07.2003.
- Akti verifikimi i datës 30.03.2005. Formular për inventarizimin bashkëlidhur planin e përgjithëshëm të vendosjes së objekteve shtetërore viti 1995.

Në vazhdim në ambientet e Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme Durrës janë sekuestruar me procesverbal dokumentat si më poshtë:

- Shkresa nr.346prot datë 26.09.2019.
- Akt konstatimi mbi situatën e objekteve pas tërmetit të datës 21.09.2019.
- Informacion i datës 27.09.2019 mbi gjedjen e hotelit pas tërmetit të datës 21.09.2019.
- Shkresa nr.8560 datë 30.10.2019 mbi organizimin e një aktiviteti në ambientet e Shtëpisë së Pushimit.
- Kontratë sipërmarrje me objekt rikonstruksioni i hotelit nr.4.
- Relacion teknik për projektin elektrik të hotelit nr.4.
- Procesverbal kolaudimi i datës 15.11.2008 në lidhje me hotelin nr. 4.
- Plan vendosje të hotelit nr.4.
- Preventivi për rikonstruksion të hotelit nr.4 për ecurinë e punimeve të datës 10.09.2007.
- Preventiv i dytë për rikonstruksionin e hotelit nr.4.
- Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme.
- Sistemi urbanistik i zonës së Shtëpisë së Pushimit të vitit 1988.
- Urdhër Prokurimi nr.388 datë 04.11.2019 së bashku me të gjithë procedurën për rikonstruksionin e hotelit nr.4 pas tërmetit të datës 21.09.2019 sipas procesverbalit.
- Janë printuar imazhe nga Google maps, të objektit.

Pas administrimit të Akt konstatimi mbi situatën e objekteve pas tërmetit të datës 21.09.2019 ka rezultuar se në datën 26.09.2019 ka ardhur në SHP (Konvaleshencë) një grup inxhinierësh i përbërë nga katër persona të Bashkisë Durrës dhe pasi është hapur godina “Hoteli Ri (nr.4)” së bashku me katër inxhinierët është bërë inspektimi i të gjithë ambienteve nga kati i parë deri në katin e pestë. Grupi i inspektimit ka parë kollonat mbajtëse, trarët, muraturën, hapësirat e ndryshme dhe të gjitha ambientet që dispononte godina. Pasi ata kanë bërë inspektimin e tyre, kanë bërë një Raport datë 26.09.2019, me titull “Akti konstatimit të situatës pas tërmetit”, ku në përfundim kanë konkluduar se në objekt kontruksioni beton arme nuk paraqet asnjë plasaritje, duke qenë se dëmet paraqiten vetëm në tullat ndarëse. Aftësia mbajtëse e objektit nuk është i cënuar, por ai aktualisht është i pashfrytëzueshëm pasi copat e tullave dhe suvave mund të shpëputen dhe të shkaktojnë aksidente në njerëz dhe në përfundim është sugjeruar si masë provizore për mosqëndrimin në këto ambiente.

Më pas shtetasi Kujtim Hasa me detyrë Shef i Shërbimeve pranë Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme, ka paraqitur Informacion datë 27.09.2019, i cili parashtrohet në mënyrë të hollësishme të gjithë gjendjen e dëmtimeve të ambienteve të hotelit. Më pas nga ana e drejtorit të Shtëpisë së Pushimit, i është dërguar informacion Ministrisë së Brendshme në lidhje me sa më sipër. Nga Shërbimet e Shtëpisë së Pushimit është bërë pastrimi i hotelit, në këtë godinë funksiononte vetëm restoranti e kuzhina, ndërsa hoteleria është pezulluar si funksion dhe nuk janë lejuar persona për akomodim.

Me datën 30.10.2019 nga ana e Ministrisë së Brendshme është kërkuar akomodimi i 112 studentëve të Akademisë së Rendit në ambientet e Shtëpisë së Pushimit pasi do të realizoheshin kurse mësimore. Më pas këto studentë janë akomoduar në ambientet e shtëpisë së pushimit, por në ambientin e hotelit nr.4 nuk është lejuar të akomodohej asnjë nga studentët. Vlen të theksohet se me leje të shefit të shërbimeve pedagogët kishin marrë në përdorim disa ambiente në godinën e Hotelit nr.4, për të lënë pajisjet mësimore etj, por jo për tu akomoduar në këtë godinë. Mirëpo me datë 26.11.2019, në orën 03:54, në kohën kur ka rënë tërmeti është konstatuar se në ambientet e katit të tretë, të Hotelit nr.4, në Shtëpinë e Pushimit, ka qenë i akomoduar i ndjeri Bajram Hajdarmetaj, pedagog në Akademinë e Rendit Publik, i cili si pasojë e shembjes së kësaj godine gjeti vdekjen.

Në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, lidhur me Organizmin, metodat e brendshme të punës dhe funksionimin e Shtëpisë së Pushimit ishte në fuqi Rregullorja nr.2197 datë 12.03.2018 e miratuar nga Ministri i Brendshëm, e cila në nenin 21 parashikonte se: Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve.

*Organizon dhe drejton punën në sektor, programon ngarkesën e punës së sektorit në përgjithësi, përcakton detyrat dhe ndjek zbatimin e tyre sipas afateve përkatëse.*

*Kryen planifikimin e përvitshëm për baze materiale, pajisje dhe shërbime të tjera të domosdoshme në përputhje me nevojat.*

*Merr masa për organizimin dhe kontrollin e punës për mirëmbajtjen e pajisjeve, orendive, ambienteve, identifikimin e problemeve, defekteve apo pengesave në funksionimin ose '» përdorimin e tyre dhe angazhohet për zgjidhjen ose riparimin përfundimtar të tyre.*

*Informon në mënyrë periodike për kapacitetet që janë në efikasitet.*

*Kontrollon respektimin e normativave të konsumit të lendeve djegëse dhe materialeve,, të tjera ndihmëse në administrimin e institucionit, referuar katalogeve teknik të prodhimit dhe standarteve të shfrytëzimit.*

*Në përputhje me programin vjetor të punës, përgatit programet mujore në nivel sektori dhe drejton punën për zbatimin rigoroz të tyre.*

*Vlerëson ecurinë dhe rezultatet vjetore të punonjësve në varesi, në përputhje me procedurat e aplikueshme.*

Lidhur me lejimin për tu akomoduar me datë 26.11.2019, të të ndjerit Bajram Hajdarmetaj në ambientet e katit të tretë, të Hotelit nr.4, në Shtëpinë e Pushimit, i cili më parë ishte shpallur i pashfrytëzueshëm, mban përgjegjësi Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve shtetasi

Kujtim Hasa, i cili ishte i ngarkuar me detyrën funksionale të organizimit dhe drejtimit të punës në sektor në përgjithësi dhe marrjen e masave për organizimin dhe kontrollin e punës për shërbimet, ambientet, bazën materiale etj.

I pandehuri Kujtim Hasa veprën penale e ka kryer me mosveprime, duke lejuar që i ndjeri Bajram Hajdarmetaj të futej dhe akomodohej në ambientet e katit të tretë, të Hotelit nr.4, në Shtëpinë e Pushimit, i cili më parë ishte shpallur i pashfrytëzueshëm, duke konsumuar kështu elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

**6.1.** Në lidhje me pasojat e ardhura në objektin e mësipërm është marrë nën hetim edhe shtetasi Ahmet Doda (me detyrë Drejtor i Shtëpisë së Pushimit në Durrës), për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Mirëpo në përfundim të hetimeve të zhvilluara rezulton se ky shtetas nuk ka nxjerrë asnjë akt të shkruar apo verbal në lidhje me lejimin e akomodimit të të ndjerit Bajram Hajdarmetaj, në godinën nr.4, të Shtëpisë së Pushimit. Në lidhje me faktin e datës 26.11.2019, ku është lejuar apo nuk është penguar i ndjeri Bajram Hajdarmetaj të akomodohej në ambientet e katit të tretë, të Hotelit nr.4, në Shtëpinë e Pushimit, i cili më parë ishte shpallur i pashfrytëzueshëm, mban përgjegjësi Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve shtetasi Kujtim Hasa, i cili ishte i ngarkuar me detyrën funksionale të organizimit dhe drejtimit të punës në sektor në përgjithësi dhe marrjen e masave për organizimin dhe kontrollin e punës për shërbimet, ambientet, bazën materiale etj.

Për sa më sipër duke qenë se nga ana e shtetasit Ahmet Doda në cilësinë e Drejtorit të Shtëpisë së Pushimit në Durrës, nuk është nxjerrë ndonjë akt me shkrim apo edhe verbal ku të përcaktohet akomodimi i të ndjerit Bajram Hajdarmetaj në ambientet e katit të tretë, të Hotelit nr.4, në Shtëpinë e Pushimit, nuk provohet se janë konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nisur sa më sipër si dhe bazuar në nenin 328 pika 1 gërma “b” dhe nenin 329/a pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, hetimet ndaj shtetasit Ahmet Doda duhen pushuar.

**7. Objekti “Hotel Vila Palma”, në zonën e quajtur Shkëmbi i Kavajës,** plazh, Durrës, nga shembja e të cilit ka humbur jetën shtetasi Sadik Qato, i cili është babai i bashkëshortit të shtetases Deshira Qato dhe pas kërkimeve me orë të zgjatura nga grupet e shpëtimit u arrit të nxirret me jetë nga rrënojat shtetasi Klajdi Qato (djali i shtetases Deshira Qato).

Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar oficerët e policisë gjyqësore të cilët kanë kryer këqyrjen e vendit të ngjarjes si dhe kanë këqyruar dhe marrë mostra nga materialet e ndërtimit të gjetura në gërmadhat e objektit të shembur (pjesë kollonash, trarësh, etj)

Në kuadër të hetimit për këtë procedim, janë sekuestruar në ASHK Durrës, dokumentat të cilat kanë shërbyer për regjistrimin fillestar të “Hotel Vila Palma”, Shkëmbi i Kavajës, si dhe ato që kanë shërbyer për regjistrimin e shtesave të kryera pa leje në objektin e mësipërm nëpërmjet procedurës së legalizimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se objekti ka filluar së ndërtuari që nga viti 2003. Për këtë ndërtim të “Hotel Vila Palma”, është nxjerrë fillimisht “Leja për miratimin e destinacionit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”, me Vendimin Nr.6 datë 26.08.2003 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Durrës, për ndërtimin e objektit katër kate plus papafingo, plus kati i parë lokal. Në dosje ndodhet Akti i Kolaudimit Tekniko Ekonomik i objektit të mësipërm.

Nga dokumentacioni i sekuestruar në Zyrën e ASHK sektori i ALUIZNI-T rezulton se: mbi këtë objekt me leje nga pronarët është bërë ndërtimit pa leje mbi objektin ekzistues. Konkretisht shtetasja Deshira Qato, në cilësinë e pronares së objektit ka aplikuar për legalizimin e shtesës së objektit me datë 10.07.2006. Në këtë vetëdeklarim SHTOJCA A1

ajo ka deklaruar se; “në objektin shtesë 2 kat mbi objektin 5 kat + papafingo + bodrum nuk ka ndryshime të gjendjes së mëparëshme dhe në këtë vetëdeklarim ndodhet edhe vula e njësisë së qeverisjes vendore Komuna Rrashbull”. Pas këtij vetëdeklarimi është krijuar dosja Nr.4100 viti 2006 tek Zyra e Aluizni-t Durrës, në lidhje me fillimin e procedurës së lagalizimit të këtij objekti.

Më pas, në vitin 2013 shtetasja Deshira Qato ka aplikuar përsëri për legalizim të shtesave të kryera në këtë objekt e konkretisht me kërkesën me Nr.2530 datë 18.07.2013, për të legalizuar shtesën e ndërtimit informal në objektin me leje, të hipotekuar, të një shtese prej dy kate dhe shtesë anësore (*pishinë 90 m<sup>2</sup>*). Për këtë kërkesë nga Drejtoria e ALUIZNI-T është përpiluar Procesverballi i konstatimit me datë 04.08.2013, Akti i kualifikimit datë 04.09.2013 dhe me procesverbalin e Vlerësimit të dosjes nr.4100, i është dhënë Leja e Legalizimit Nr.92274 datë 29.08.2013. Në dokumentacionin për dhënien e lejes së legalizimit ndodhet edhe një dokument “Akti ekspertimit teknik për shtesën 2 kate + shtesë anësore mbi objektin e hipotekuar 5 kate + pafingo + bodrum” me investitore Deshira Qato, i mbajtur nga Eksperti Arben Qato (i cili është bashkëshorti i shtetasës Deshira Qato).

Në funksion të hetimeve të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore si:

- Këqyrja e vendit të ngjarjes së bashku me tabelat fotografike përkatëse.
- Marrja e mostrave të hekurit dhe betonit në rrënojat e këtij objekti.
- Analizat laboratorike të cilësisë së hekurit dhe betonit.
- Informacion nga Instituti i Gjeoshkencave Energjisë, Ujit dhe Mjedisit lidhur me lëkundjet e tërmetit të datës 26.11.2019.
- Studimi Sizmiologjik.
- Studimi Gjeologjik i sheshit të ndërtimit.
- Dokumentacioni tekniko-ligjor i objektit.
- Si dhe një numër i madh veprimesh të tjera hetimore si deklarime të personave që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale, etj.

Nga ana jonë me qëllim sqarimin e fakteve nëse, Projektimi, Zbatimi, Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i ndërtesës godinës ish-objekti “Hotel Vila Palma”, lagjia nr.13, Durrës, kanë qenë në përputhje me kushtet teknike kombëtare dhe kuadrin rregullator ligjor për ndërtimin në RSH si dhe për të përcaktuar shkaqet që kanë sjellë shembjen e ndërtesës është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik.

Nga Akti Ekspertimi Teknik përkatës në lidhje me objektin 5+1 kate, ish-“Hotel Vila Palma”, ka rezultuar ndër të tjera se:

*Ndërtesa “Hotel Vila Palma”, e ndodhur në lagjen nr.13, pranë Shkëmbit të Kavajës, Durrës, objekt i këtij akti ekspertimi është një godinë e ndërtuar me faza. Në periudhën Qershor – Nëntor 2005 është ndërtuar fillimisht objekti “Banesë 4kat + lokal + papafingo”. Për këtë ndërtim, në dosje mungon projekti konstruktiv. Në vijim janë bërë disa shtesa që konsistojnë në zgjerimin e katit përdhe dhe 2.5 kate shtesë mbi atë ekzistuese. Fillimisht është bërë një zgjerim + papafingo në periudhën Janar-Prill 2009. Për këtë shtesë, mungon projekti konstruktiv. Periudha në të cilën janë bërë 2.5 kate shtesë nuk del qartë nga dokumentacioni që administrohet në dosjen hetimore, ose më konkretisht disa dokumente referojnë fakte të rreme sa i përket periudhës së zbatimit të shtesave.*

*Kjo ndërtesë nuk është Projektuar, Zbatuar dhe Kolauduar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi në vendin tonë në kohën e kryerjes së ndërtimit. Sa i përket zbatimit të KTP dhe KTZ të pacaktuara në VKM Nr. 68, dt. 15.2.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, grupi i ekspertëve nuk mund të shprehet pasi në dosje mungon projekti konstruktiv dhe gjithashtu dosja e zbatimit ka mjaft mangësi.*

*Duke u nisur nga i gjithë dokumentacioni i dosjes hetimore dhe bazuar në interpretime inxhinierike, ekspertët konkludojnë që ndër arsyet kryesore që mund të kenë sjellë shembjen e objektit apo struktura mbajtëse të Hotel Vila Palmës është fakti se mbi ndërtesën e Hotel*

Vila Palmës rezultojnë të shtuara 3 kate, fakt ky që ka rritur ndjeshëm masën e ndërtesës (forcat sizmike që shfaqen në rast tërmeti) dhe sforcimet në katet e poshtme të strukturës. Siç rezulton edhe nga dokumentacioni i administruar në dosjen hetimore shtesa 3 kat është bërë pa një projekt strukturor dhe si rrjedhim pa konsideruar llogaritjet strukturore për të verifikuar ndikimin e kësaj shtese në qëndrueshmërinë integrale të ndërtesës në rast tërmeti. Siç referohet në Akt Ekspertizës me Objekt: “Shtesë 2 kate + Shtesë anësore mbi objekt të hipotekuar 5 kate + papafingo + bodrum - Investitor Dëshira Qato”, hartuar nga kompania “Universal Engineering 08”, me përfaqësues ligjor Inxh. Arben Qato. “Objekti (shtesa) është ndërtuar sipas projekt idesë të hartuar nga specialistë dhe zbatuar nga vetë investitori me grupe pune të ndjekur nga teknikë zbatimi”. Konstatohet që edhe zbatimi i shtesës është bërë nga grupe pune, të pa licencuar për të kryer vepra ndërtimore dhe pa mbajtur asnjë dokumentacion për zbatimin e veprës (shtesës). Gjithashtu në këtë akt ekspertizë, citohet që, materialet e përdorura për realizimin e shtesës janë Profile Xinkato (me përmasa 200x200mm) të cilat pavarësisht se krijojnë një strukturë të lehtësuar (krahasuar me elementë b/arme), por kurrësi nuk justifikojnë mangësinë në përforcimet strukturore të elementëve mbajtës ekzistues që duheshin realizuar përpara se të realizohej shtesa.

Sa më sipër, konkludohet që gjitha shtesat dhe ndërhyrjet në objektin “4 kat + lokal + papafingo” nuk kanë respektuar Kushtet Teknike të Projektimit dhe Zbatimit në fuqi në vendin tonë. Mos zbatimi i këtyre Kushteve Teknike, përveçse shkelje ligjore, ka sjellë mos zbatimin dhe realizimin e mjaft detajeve konstruktive të cilat parashikohen specifikisht për rastet kur ndërtesat i nënshtrohen veprimeve sizmike duke sjellë kështu një ndër arsyt kryesore të dëmtimeve që ndikojnë në qëndrueshmërinë integrale të ndërtesës.

Referuar Raportit mbi Kushtet Gjeologo-Inxhinierike të sheshit të ndërtimit ku ka qenë Hotel Vila Palma, konstatojmë themelet e ndërtesës kanë qenë të mbështetura në një taban (formacion gjeologjik) me karakteristika fiziko mekanike mjaft të dobëta dhe me prezencë të lartë të ujërave nëntokësorë. Gjithashtu, duke analizuar edhe shtresat e tjera poshtë saj konstatojmë pak a shumë të njëjtat formacione të dobëta. Sa më sipër, në këto raste për ndërtimin e ndërtesave shumë katëshe është e domosdoshme marrja në konsideratë dhe realizimi i masave përmirësuese të posaçme me qëllim rritjen e aftësisë mbajtëse dhe shpërndarjen uniforme të ngarkesave në taban.

Sheshi i ndërtimit ku ndodhej Hotel Vila Palma, bazuar në Hartën e Mikrozonimit Sizmik të rajonit të Durrësit (1985), kategorizohet si një zonë me intensitet sizmik IX ballë dhe si e tillë është një ndër zonat më të rrezikuara të vendit tonë sa i përket rrezikut sizmik. Të dhënat e rrjetit akselometrik<sup>1</sup> (të instaluar në oborrin e Ndërmarrjes së Ujësjiellit në Durrës) pavarësisht se kanë regjistruar vetëm 15 sek e para të ngjarjes sizmike të 26 Nëntorit 2019 konfirmojnë që tërmeti i rënë përkon me rrezikun sizmik të parashikuar në studimet sizmike dhe Hartën e Mikrozonimit të Durrësit. Konkretisht, ngjarja sizmike e 26 Nëntorit 2019 përkon me rrezikun sizmik për të cilat duhet të projektohen ndërtimet në këtë zonë, që do thotë që ndërtesat e projektuara e të zbatuara në përputhje të plotë të KTP dhe KTZ në vendin tonë, mund të pësojnë dëmtime lokale, në element strukturor ose jo-strukturorë, por duhet të rezistojnë pa u shembur nga një ngjarje e tillë sizmike.

Ne perfundim ekspertet shprehën se: shembja e ndërtesës së Hotel Vila Palma, Lagja 13, pranë Shkëmbit të Kavajës, Durrës, ka ndodhur nga disa faktorë të cilët u paraqiten mësipër por kryesisht nga mos respektimi i masave të parashikuara në KTP dhe KTZ, gjatë realizimit të shtesave pa kriter dhe pa u bazuar në llogaritje të sakta inxhinierike të aftësisë mbajtëse të strukturës ekzistuese.

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së ndërtimit të objektit “Hotel Vila Palma”, lagjia nr.13, Durrës, shtetasja Dëshira Qato në cilësinë e investitore dhe pronares së objektit duke kryer shtesa pa lejen e organeve kompetente dhe duke mos respektuar masat e parashikuara në KTP dhe KTZ, gjatë realizimit të shtesave pa kriter dhe pa u bazuar në llogaritje të sakta inxhinierike të aftësisë mbajtëse të strukturës ekzistuese, me veprimet dhe

<sup>1</sup> Sipas letërkëmbimit me IGJEUM

mosveprimet e saj ka konsumuar elementët e veprës penale të “Vrasja nga pakujdesia” parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, në dëm të viktimës Sadik Qato. Shtetesja Deshira Qato ka kryer ndërtimin e objektit 8+1 kate, pa respektuar rregullat dhe normat ligjore në fushën e ndërtimit përsa i përket studimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objektit ndërtimor, gjë e cila ka sjellë si pasojë shembjen e objektit nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe vdekjen e shtetasit Sadik Qato që gjendej në këtë objekt.

Nga ana e të pandehurës Deshira Qato pavarësisht se po ndërtonte një objekt ndërtimor 4+1 kate + bodrum fillimisht me leje ndërtimi dhe më pas një shtesë 2+1 kate pa leje, me funksion social-ekonomik “Hotel”, në kundërshtim me ligjin nuk ka pajtuar asnjë specialist të fushës së projektimit konstruktiv dhe ndërtimit. Po kështu, edhe gjatë zbatimit të punimeve nuk është mbajtur asnjë lloj dokumentacioni për cilësinë e materialeve të ndërtimit, cilësinë e punimeve dhe mbi volumet e punimeve të kryera në këtë objekt, (libër masash mbi punimet e kryera dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit të përdorur, situacionet e punimeve, akt kolaudimi apo ekspertimi teknik lidhur me qëndrueshmërinë sipas parashikimeve ligjore, etj).

E pandehura Deshira Qato me dashje direkte e ka kryer ndërtimin e shtesës së objektit në mënyrë të kundraligjshme dhe pa lejen e organeve kompetente, duke besuar tek aftësitë e saj apo personave që kanë marrë pjesë në ndërtimin e këtij objekti, se objekti mund të jetë i qëndrueshëm nga pikëpamja teknike, por pasojat e ardhura nga shembja e ndërtesës së ndërtuar nga vetë ajo kanë ardhur nga pakujdesia, pasi ajo nuk i ka parashikuar pasojat që mund të vinin, megjithëse sipas rrethanave në të cilat është kryer ndërtimi ajo duhet ti parashikonte (ajo vetë dhe familja e saj banonin në këtë objekt, ku si pasojë gjeti vdekjen edhe babai i bashkëshortit të saj).

E pandehura Deshira Qato, jo vetëm nuk i është përmbajtur legjislacionit në fushën e ndërtimit lidhur me KTP e KTZ, por edhe për legalizimin e objektit ka përdorur në mënyrë fiktive një “Akt Ekspertizë mbi qëndrueshmërinë konstruktive të objektit” e cila nuk i plotëson kushtet teknike dhe ligjore dhe nuk plotëson kushtet e përmbajtjes së tij sipas parashikimeve të Ligjit Nr.9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Nisur nga sa më sipër dhe mbështetur në faktet dhe provat e administruara në funksion të hetimeve të procedimit penal nr.2466 viti 2019 rezulton se me veprimet dhe mosveprimet e saj e pandehura Deshira Qato ka konsumuar elementët e veprës penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal në dëm të viktimës Sadik Qato.

**7.1.** Siç shikohet edhe më lart, nga Akt Ekspertimi Teknik, konstatohet se i gjithë teksti i akt ekspertizës i mbajtur nga i pandehuri Arben Qato, ka mjaft mospërputhje me ato që vetë autori citon në paragrafë të ndryshëm dhe nuk ka aspak karakter teknik. Duket si një dokument i sajuar për të plotësuar dokumentacionin që kërkohej nga organet shtetërore për legalizim dhe nuk mund të merret në konsideratë për t’u bazuar për të nxjerrë vlerësime inxhinierike. Evidentohet qartë edhe fakti që shtesa është realizuar pa konsideruar aftësinë mbajtëse të strukturës ekzistuese dhe pa kryer llogaritjet e nevojshme inxhinierike për realizimin e projektit konstruktiv të shtesës dhe përforcimeve të nevojshme të strukturës ekzistuese.

Në përfundim ekspertët shprehen se: shembja e ndërtesës së Hotel Vila Palma, Lagja 13, pranë Shkëmbit të Kavajës, Durrës, ka ndodhur nga disa faktorë të cilët u paraqiten mësipër por kryesisht nga mos respektimi i masave të parashikuara në KTP dhe KTZ, gjatë realizimit të shtesave pa kriter dhe pa u bazuar në llogaritje të sakta inxhinierike të aftësisë mbajtëse të strukturës ekzistuese.

Vlen të theksohet gjithashtu se në nenin 12/2 e vijim të Ligj nr.8402 dt 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” është përcaktuar qarte se:

*Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë. Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit. Investitori do të përcaktojë afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit.*

Gjithashtu, edhe në udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 “Për disiplinimin e punimeve në ndërtim” në pikën II/3 e vijim përcaktohet se:

**3. Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:**

*a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.*

*b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.*

*c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.*

*ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.*

**4. Kur vërehen defekte në verifikimet që përcaktohen në pikën 3, kolaudatori ose grupi i kolaudimit lë detyra me shkrim për punimet që duhet të kryhen, duke përcaktuar afatet e përfundimit të tyre, në mënyrë që të plotësohen të gjitha kushtet e pikës 3. Në varësi nga natyra e këtyre defekteve përcaktohen detyrimet e secilës palë.**

Nisur nga sa më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së Akt-Ekspertizës me Objekt: “Shtesë 2 kate + Shtesë anësore mbi objekt të hipotekuar 5 kate + papafingo + bodrum - Investitor Dëshira Qato”, shtetasi Arben Qato në cilësinë e Inxhinierit dhe përfaqësuesit ligjor të kompanisë “Universal Engineering 08”, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Shtetasi Arben Qato në cilësinë e inxhinierit të pajisur me leje (licensë) për çertifikimin dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim, ka kryer në kundërshtim me ligjin dhe detyrën e tij nje Akt Kolaudimi, i cili ka mjaft mospërputhje dhe pa aspak karakter teknik. Ai ka hartuar nje Akt Kolaudimi të sajuar vetëm për të plotësuar dokumentacionin që kërkohet nga organet shtetërore për legalizim dhe nuk mund të merrej në konsideratë për t’u bazuar për të nxjerrë vlerësime inxhinierike. Evidentohet qartë edhe fakti që shtesa është realizuar pa konsideruar aftësinë mbajtëse të strukturës ekzistuese dhe pa kryer llogaritjet e nevojshme inxhinierike për realizimin e projektit konstruktiv të shtesës dhe përforcimeve të nevojshme të strukturës ekzistuese.

Bazuar në sa më sipër, provohet se i pandehuri Arben Qato më veprimet e tij ka kryer veprën penale “Shpërdorimi i Detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Këto rrethana provohen me provat e cituara më lart për çdo rast si dhe me dëshmitarët sipas listës përkatëse bashkëlidhur kësaj kërkesë.

Fakti i provuar me provat e mësipërme përbën veprën penale “Vrasja nga pakujdesia” parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, pasi të pandehurit Ramiz Shehu, Ruzhdi Xheka, Abdulla Osmani dhe Dëshira Qato me veprimet e tyre kriminale kanë çenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar jetën e personit, të mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni ynë penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale të tilla si kryerja e ndërtimeve në mënyrë të kundraligjshme, pa respektuar standardet teknike të projektimit, parashikimit sizmik, gjeologjisë së truallit, standardet e zbatimit, kolaudimit, etj, si dhe duke ndërtuar pa lejen e organeve kompetente, duke besuar se objekti mund të jetë i qëndrueshëm nga pikëpamja teknike. Si pasojë ka ardhur shembja e ndërtesave të mesiperme dhe vdekja e personave që



qëndronin në to. Sidoqoftë vlen të theksohet se të pandehurit e mësipërm nuk i kanë parashikuar pasojat që mund të vinin, megjithëse sipas rrethanave në të cilat është kryer ndërtimi ata duhet ti parashikonin.

Së dyti: fakt i provuar me provat e mësipërme përbën veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal, pasi i pandehuri Artur Terziu, me veprimet e tij kriminale ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar regjimin juridik të tokës në përgjithësi dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim në veçanti, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. I pandehuri e ka kryer veprën duke kryer pa lejen e organeve kompetente ndërtimin e një objekti shtesë me sipërfaqe 26 m<sup>2</sup>.

Se treti: Fakti i provuar me provat e mësipërme përbën veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, pasi i pandehuri Artur Terziu me veprimet e tij kriminale ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore dhe publike, në vërtetësinë e dokumentave të paraqitura, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, duke paraqitur një Akt Ekspertizë të falsifikuar me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për të legalizuar shtesën pa leje. Po kështu edhe e pandehura Nevjana Isufi, duke përgatitur dhe nënshkruar një akt ekspertimi topografik, në emër të topografit Vasil Gjoni, ka konsumuar elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

Se katërti: Fakti i provuar me provat e mësipërme përbën veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi të pandehurit Arben Qato, Flamur Gjuzi, Arsen Malko, Skerdi Bello, Albrend Qetka, Arben Isaku, Aldo Dakoveli, Artur Çela, Klajdi Lame dhe Kujtim Hasa, me veprimet e tyre kriminale kanë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, që kanë të bëjnë me kolaudimin e objekteve ndërtimore, me legalizimin e ndërtimeve pa leje, me mbikëqyrjen dhe kontrollin e territorit, si dhe me mirëadministrimin e pronës së shpallur të pashfrytëzueshme të Ministrisë së Brendshme, në lidhje me sigurinë e punonjësve që hyjnë në këto ambiente.

Nga ana tjetër nga hetimet nuk u arrit të provohet se shtetasi Defrim Celami të ketë hartuar dhe nënshkruar “Akt ekspertimi” datë 09.05.2016-12.05.2016 dhe si i tillë nuk provohet se ka konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Duke u nisur nga sa më sipër si dhe bazuar në kërkesat e nenit 328 pika 1 gërma “dh” dhe nenin 329/a pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, hetimet në ngarkim të tij duhet të pushohen.

Se fundmi: nga hetimet e kryera në ngarkim të shtetasit Ahmet Doda, në cilësinë e Drejtorit të Shtëpisë së Pushimit në Durrës, nuk u arrit të provohet se është nxjerrë ndonjë akt me shkrim apo edhe verbal ku të përcaktohet akomodimi i të ndjerit Bajram Hajdarmetaj në ambientet e katit të tretë, të Hotelit nr.4, në Shtëpinë e Pushimit dhe në këto kushte nuk provohet se janë konsumuar elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Duke u nisur nga sa më sipër si dhe bazuar në kërkesat e nenit 328 pika 1 gërma “dh” dhe nenin 329/a pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, hetimet në ngarkim të tij duhet të pushohen.

Për arsyet e sipër përmendura dhe nisur nga fakti se të pandehurit janë të përgjegjshëm përpara ligjit dhe kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, si dhe veprën penale e kanë kryer me dashje ose nga pakujdesia sipas akuzës së secilit të pandehur, çështja në ngarkim të tyre është dërguar për Gjykim.

Me konkretishte nga ana e organit të akuzës u dërguan për gjykim në funksion të çështjes penale nr. 2466, viti 2019, të pandehurit si vijon:

1. **Ramiz Shehu**, të akuzuar sipas nenit 85 tetë herë të Kodit Penal,
  2. **Nevjana Isufi**, të akuzuar sipas nenit 186/1 të Kodit Penal,
  3. **Abdulla Osmani**, të akuzuar sipas nenit 85 dy herë të Kodit Penal,
  4. **Ruzhdi Xheka**, të akuzuar sipas nenit 85 dy herë të Kodit Penal,
  5. **Arben Isaku**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  6. **Aldo Dakoveli**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  7. **Artur Terziu**, të akuzuar sipas nenit 186/1 dhe 199/a/3 të Kodit Penal,
  8. **Artur Çela**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  9. **Klajdi Lame**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  10. **Flamur Gjuzi**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  11. **Albrend Qetka**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  12. **Skerdi Bello**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  13. **Artenis Malko**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
  14. **Deshira Qato**, të akuzuar sipas nenit 85 të Kodit Penal,
  15. **Arben Qato**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal dhe
  16. **Kujtim Hasa**, të akuzuar sipas nenit 248 të Kodit Penal,
- si dhe do kerkohet
- Pushimi i ndjekjes penale për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Defrim Celami.
  - Pushimin e ndjekjes penale për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Ahmet Doda.